

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7594 E premte 20 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

**Q**ë nga rrëzimi i komunizmit ka zënë fill një proces i pandalur i përsosjes e ndryshimit të modelit të sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare ...  
Vijon në faqen 20-21

Nga VASIL KURETA

A po ndryshon rendi e rregulli botëror




Opinion

Ditës

**P**aulin Ndreun e kisha dëgjuar si emër në një ndër denoncimet e qytetarit digjital të Doktorit, por do ta kisha harruar si shumë emra që përmenden ...  
Vijon në faqen 21

Nga DRITAN HILA

Paulin Ndreu, historia e malësorit që dashuron detin



Tentoi të qëllojë policin, ai e plagos

## RENEA, "luftë" në Radhimë me të kërkuarin për vjedhje banke

Arrestohet Gaqo Gjini, flet i vjehri: Ai s'ka bukë të hajë, i terrorizuan familjen

VLOREË. Një aksion i policisë së Vlorës dhe i forcave speciale për kapjen e një të kërkuarit për grabitje banke ka shkaktuar panik tek banorët, pushuesit dhe turistët në Radhimë. Mësohet se blutë dhe RENEA kanë rrethuar banesën (e kishte marrë me qira) ku ndodhej 38-vjeçari Gaqo Gjini dhe i kanë bërë thirrje që të dorëzohet ...  
Në faqen 11

## TABELA/ ÇMIMET PËR SHITBLERJE, DHURIM, REGJISTRIM DHE VERIFIKIM

# HIPOTEKA, DOKUMENTET PËR NDRYSHIMET E PRONESISE

Tarifat që paguhen në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive për çdo veprim me pronat.

Kryeregjistruesi: Më shumë sportele për emigrantët që vijnë me pushime



(Në foto) Pallate në Tiranë

Në faqen 7

DEBATI NE KUVEND

**PD kërkon rivotim të ligjit për Teatrin, braktis seancën plenare**

Në faqen 3

SKANDALI

**Admir Thanza fshehu dënimin, prokuroria nis letërporosi në Itali**

Në faqen 9

KUOTAT DHE BUXHETI

**UET, në një vit 750 mijë euro për 500 bursa të plota e gjysmëbursa**

Në faqen 12

ZBARDHET KRIMI

**Fushë-Krujë, i riu u ekzekutua dhe u gropos në parcelën me kanabis**

Në faqen 8

"VIP PAGES"



**Rrëfimi i Kastriot Zizos: Kam shumë pengje në jetë dhe pak lumturi**

Suplement

Vajza e "Mandelës" shqiptar, Justina Arbnori: Jeta e tij, pa kompromise

## Busti i Arbnorit në Kuvend bashkon PS e PD

Ruçi: I dashur për të gjithë. Mustafaj: Do ishte kundërshtar i Gramozit

Nga VALENTINA MADANI

Dymbëdhjetë vite pas ndarjes nga jeta, Pjetër Arbnori ose siç njihet ndryshe "Mandela" i shqiptarëve, dje u "rikthye" sërish në Kuvend. Përrurimi i bustit të Arbnorit, i vendosur përpara selisë së parlamentit arriti



t'i bëjë bashkë të majtë e të djathtë, të paktën për një orë. Fjalimet protokollare në këtë ceremoni u zëvendësuan nga ndjesa për harresën që politika i bëri ndër vite "Mandelës" shqiptar. Ndryshe nga vendimi në këshillin bashkiak ...

Në faqen 5

**PARLAMENT  
DEBATET**

Mungojnë votat, shtyhen për në seancën e fundit ligji i magistratëve dhe Kodi Rrugor

# "Magjistratët", Balla thirrje LSI-së: Ta votojmë së bashku, siç na kërkoi Hahn

*Vasili: Rilindja luan kungulleshkën me ligjin e magistraturës*

Darina Tanushi

Partia Socialiste i bëri thirrje dhe opozitës të votojnë së bashku ligjin për magistraturën. Pas braktisjes së Kuvendit nga ana e opozitës, kreu i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla i akuzoi deputetët e PD-së se nuk po marrin parasysh kërkesën e komisionierit Johannes Hahn për mosbojkitim të seancës. "Këtu po risjell në vëmendje kërkesën e ardhur nga komisionieri Hahn drejtuar opozitës, që nuk kanë asnjë arsye të qenësishme që përmes një bojkoti të shpikur për një çështje që nuk ekziston, të bllokojnë votimin në Kuvend, shtyrjen qoftë edhe me një vit dhe këtu jam i gatshëm të bëj një propozim në emër të grupit parlamentar të PS-së drejtuar opozitës, e në mënyrë të veçantë LSI-së, të cilët e kanë bashkëvotuar me ne këtë draft që është gati, të mos e shtyjmë për dy vjet, ta shtyjmë vetëm për një vit, vetëm për vitin shkollor të Magjistraturës për 2018-2019 për të pranuar 50 djem dhe vajza ekselentë në drejtësi për të vijuar karrierën e tyre në profesionin, që sot është më i nevojshmi dhe më i dobishmi për forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, sikurse është Magjistratura, sepse do të jenë këta magistratë të rinj, qofshin gjyqtarë apo prokurorë që do të plotësojnë këto vakanca që drejtë", u shpreh dje Balla. "Përse e bëme ne vetingun, që të qëndronin ata që ishin? Kush nuk e ka ditur që vetingu do të prodhonte vakanca, nuk e paska ditur çfarë ka votuar sot e dy vite në këtë seancë? Për tri ditë bëjmë dy vite nga momenti që kemi votuar me 140 vota nga kjo sallë paketën kushtetuese të Reformës në Drejtësi. Vetingu i prodhoi vakancat dhe kush është kundër plotësimit dhe vijimit të vitit shkollor nga magistratura, sigurisht që është duke votuar kundër vetvetes



Kreu i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla

**BALLA-RAMA**

Menjëherë pas thirrjes së kreu të grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla u pa të bisedonte për gati 20 minuta në sallën e Kuvendit me nënkryetarin e LSI-së, Luan Rama. Nuk dihet se çfarë kanë diskutuar mes tyre dy figurat shumë të rëndësishme të partive përkatëse, por marrë shkasë nga tema e ditës, Balla mund t'i ketë kërkuar Ramës të përdorë influencën e tij në parti për të siguruar votat e mjaftueshme për miratimin e ligjit.



**PS-PD bëhen bashkë, shtyjnë me 6 muaj afatin e Komisionit të Reformës Zgjedhore**

Dy bashkëkryetarët e Komisionit të Reformës Zgjedhore, Bledi Çuçi dhe Oerd Bylykbashi i janë drejtuar me një kërkesë Kuvendit për të shtyrë edhe me 6 muaj të tjerë afatin e këtij komisioni. Komisioni i Reformës Zgjedhore është krijuar në dhjetor të 2017-ës, ndërkohë që afati është shtyrë edhe më 29 mars, me 4 muaj. Tashmë po kërkohet një tjetër afat 6-mujor për të mbyllur punën për ndryshimet në Kodin Zgjedhor. Deri më tani janë zhvilluar disa seanca dëgjeshme me aktorë të shoqërisë civile, por është ende shumë herët për të dalë me një draft ndryshimesh.

Mazhoranca ka ndryshuar sërish propozimin e saj për fatin e atyre që janë djegur nga vetingu. "Report TV" zbulon një amendament të ri të socialistëve, të cilët kërkojnë të ndryshojnë vendimin e Komisionit të Ligjeve. Partia Socialiste ndryshon mendje për të tretën herë për lejimin ose jo për të ushtruar profesionin e avokatit të gjyqtarëve e prokurorëve që digjen nga vetingu. Gatishmëria për t'i penguar të shkarkuarit u shpreh në 2 maj, kur u prezantua ligji për avokatinë, por në 3 korrik, Komisioni i Ligjeve, me të gjitha votat, përjashtuar atë të Bashkimit Finos, nuk e përfshiu nënën që bllokoi gjyqtarët e prokurorët që ngelin në klasën e vetingut për t'u bërë avokatë. Por presio-

**Propozimi i ri në projektligjin "Për titullin e avokatit"**

## PS ndryshon qëndrim: Të djegurit nga vetingu të mos rikthehen si avokatë



ni amerikan ka vepruar mbi mazhorancën, duke e detyruar të bëjë një amendament në seancën plenare që nuk lejon të skualifikuarit e vetingut të hyjnë në sallën e gjyqit si avokatë. Amendamenti është firmosur nga kryetari i grupit socialist, Taulant Balla, por edhe nga kryetari i Komisionit të Ligjeve. Në ndryshimin që kërkohet t'i bëhet ligjit "Fiti-mi i titullit të avokatit" të thuhet: "Nuk është shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose funksionit publik për arsye të integritetit etik, me vendim të organit kompetent që ka marrë formë të prerë, me përjashtim të rasteve kur masa disiplinore është shuar sipas legjislacionit të posaçëm". Për Ulsi Manjën, ky është qëndrimi i tretë zyrtar i ndry-

shëm për të njëjtën çështje. Sipas amendamentit "Balla-Manja", që pritet të hidhet në votim të hënën, nuk duhet të lejohet që të skualifikuarit të bëhen avokatë. Mazhoranca ende mendon që kjo nisimë është antikushtetuese, sepse cenon një profesion të lirë, por të njëjtat burime saktësojnë se ky amendament vjen pas një këmbënguljeje të palëkundur të ekspertëve amerikanë që po asistojnë Komisionin e Ligjeve në përgatitjen e akteve të tjera të zbatimit të reformës në drejtësi.

një moment të rëndësishëm për kujtimor për një figurë të rëndësishme të opozitës sikurse është Pjetër Arbnori, por nëse do të ishte Pjetër Arbnori sot gjallë, do të ishte mirë që të ndiqnin sado pak edhe mendimet e vyerat të tij e Partia Demokratike

do të ishte sot në sallën e Kuvendit", tha Balla në fjalën e tij. Në fund të seancës, dy ligjet që kërkojnë shumicë të cilësuar votash, Kodi Rrugor dhe ligji i magistraturës u shtynë për në seancën e fundit të Kuvendit, më datë 23 korrik, me kërkesën e Ballës.

**REAGIMI**

Menjëherë pas thirrjes së bërë nga Balla, kreu i grupit të LSI-së, Petrit Vasili u shpreh se qeveria po luan kungulleshkën me ligjin e magistraturës dhe se Reforma në Drejtësi për ta është thjesht një pazar i rëndomtë. "Propozoi Rilindja një ligj që i jepte fuqi Kuvendit të vendoste për shkollën e magistraturës për 2 vjet. Pastaj e çuan në një. Me Kungulleshkë do ta bëjnë drejtësinë. Se kjo kungulleshkë është: themi dy vjet. Po pse dy? Po sa? Pa limit. Po pse pa limit. Po sa? Themi një vit. LSI beson vetëm tek parimet e Komisionit të Venecias dhe tek 21-22 korriku, gjithçka jash-të tyre është rricklimi i pisët i drejtësisë së vjetër, por të kapur sot fort në grusht nga Rilindja", u shpreh dje Vasili. "Rilindja sot, (dje) e bëri të qartë që Reforma në Drejtësi për të është asgjë më shumë se një pazar i rëndomtë njerëzish të rëndomtë", u shpreh Vasili.



Majko i ndërpret fjalën, Berisha: Ti Pandeli mos fol, ty të largojnë e të kthejnë prapë

# Ligji për teatrin, PD kërkon rivotim dhe largohet nga Kuvendi

*Spaho: U vodhën votat. Hysi: Ditë të mbarë!*

Valentina Madani

Opozita kërkoj dje rivotimin e ligjit për Teatrin Kombëtar nëpërmjet Edmond Spahos dhe pasi iu refuzua kjo kërkesë nga Vasilika Hysi, deputetët e saj u larguan nga salla e Kuvendit. Ndaj, opozita braktisi seancën e djeshme parlamentare në shenjë proteste për mospërsëritjen e votimit për ligjin që i hap rrugë shembjes së Teatrit Kombëtar. Qëndrimi i saj në seancë zgjati vetëm dy orë. Menjëherë pas raportimit të kreu të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe fjalës përshëndetëse të presidentes kroate, deputetët e opozitës braktisën punimet e Kuvendit. Pjesëmarrjen në seancë e kushtëzuan me rikthimin për votim të ligjit për Teatrin Kombëtar. Në emër të grupeve parlamentare opozitare foli Edmond Spaho nga PD, i cili tha se votimi i ligjit për teatrin ishte i parregullt, ndaj duhet të përsëritet. Duke qenë se kjo gjë nuk është marrë parasysh, Spaho tha se opozita do të largohet nga seanca, pasi nuk mund të qëndrojnë në një Kuvend ku vidhet vota. "Ne duam të rivotohet ligji për prishjen e Teatrit Kombëtar, sepse një nga deputetët e mazhorancës kishte votuar edhe për një deputet të opozitës. Dhe kryetari i Kuvendit porositi që të mblidhej Këshilli i Votimeve dhe Procedurave, i cili u mblodh dhe vërtetoi qëndrimin e opozitës që votimi në emër të një deputeti të opozitës ishte kryer, pavarësisht nga pretendimet e palëve se kush e kishte kryer. Sa kohë që ky votim ka qenë i parregullt në përputhje me rregulloren duhet të përsëritet. Për rrjedhojë, në emër të grupeve të opozitës kërkoj që të rivotohet ligji për teatrin, pasi ka qenë i parregullt. Për shkak se ju nuk lejoni që të korrigjohet ky veprim i gabuar nga ana e Kuvendit, në shenjë proteste ne do largohemi nga kjo seancë, pasi nuk mund të qëndrojmë në një Kuvend ku vidhet vota edhe kur nuk ka nevojë për ta bërë këtë", deklaroi Spaho. Ndërkaq, kryesuesja e seancës, deputetja socialiste Vasilika Hysi u ka uruar ditë të mbarë kolegëve demokratë.



Kryetari grupit parlamentar të PD, Edmond Spaho

**GAZMEND BARDHI**

"Rama mund të miratojë një ligj për të mbyllur mediat private dhe s'ka Gjykatë Kushtetuese për ta ndaluar një gjë të tillë. Mund të nxjerrë një ligj që pushkatohej në gjithë ata që flasin kundër qeverisë dhe prapë s'ka Gjykatë Kushtetuese që e ndalon", tha këshilltari për çështjet ligjore në PD.

## Mediu: Rama ekzekutoi drejtësinë, jemi në kushtet e një grushti shteti

Kreu i PR-së, Fatmir Mediu e përqendroi fjalën e tij tek rënia e shtetit për shkak të mosfunksionimit të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë. Ai e quajti situatën aktuale një grusht shteti. "Ne jemi në kushtet e një grushti shteti dhe banditizmi kushtetues. Nuk kemi Gjykatë Kushtetuese, nuk kemi Gjykatë të Lartë, nuk do ketë Gjykata Apeli, nuk do ketë gjykata rrethesh së shpejti. Pra, faktikisht shteti ka rënë sepse një nga kolonat e tij më të rëndësishme, ajo e pushtetit gjyqësor nuk ekziston dhe nuk funksionon", u shpreh Mediu. Sipas tij, "kjo është situatë e skandaloze, ne jemi kthyer në republikë bananesh dhe Republika Parlamentare Kushtetuese ka pushuar së funksionuari. Sepse çdo Republikë Parlamentare ka tri pushtete bazë që garantojnë funksionimin e shtetit dhe të drejtat e shtetasve, ato janë të pavarura dhe ndërveprim i cili garantohej nga parimi check and balance (Kontrollit dhe Balancimit)". Rënia e pushtetit gjyqësor do të thotë rënia e shtetit, rënia e qytetarëve dhe të drejtave të tyre, sepse është pushteti gjyqësor, ai që mbrohet qytetarin nga abuzimi i shtetit, i qeverisë, i parlamentit dhe është gjyqësori që garanton dhe detyron zgjidhjen e të drejtave të tij", tha z.Mediu.



## Raporti i KLSH, dëmi në buxhetin e shtetit 825.6 mln euro

### Berisha i kërkon Leskajt ta quajë Ramën kryehajdut. Kreu i KLSH: Nuk i kaloj vijat

Kreu i KLSH-së, Bujar Leskaj prezantoi para parlamentit dhe raportin e këtij institucioni për vitin 2017, ku tha se dëmi që i është shkaktuar shtetit në këtë vit është rreth 825.6 mln euro. Leskaj i kërkoj Kuvendit të rrisë presionin për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së. "Po, duhet të rritet edhe trysnia nga Kuvendi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së. Vendimi më i fundit që ka marrë Kuvendi i Shqipërisë për krijimin e mekanizmit të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura, ku zbatimi i rekomandimeve të KLSH zë vendin kryesor, unë gjykoj që është pozitiv, do të jetë pozitiv dhe do të sjellë frytë në të ardhmen", theksoi z.Leskaj. Në parlament, Leskaj u përball me një kërkesë të ish-kryeministrit Sali Berisha: "Herë tjetër ki parasysh, t'u drejtohesha hajdut dhe kryehajdut këtyre. Kjo është gjuha që njohin këta". Por Leskaj u kundërpërgjigj: "I dashur Doktor, besoj se KLSH dhe unë e kemi bërë punën time audituese. Nuk mund të kalojmë ato vija që ligji nuk na i lejon. Ne audituesit nuk bëjmë politikë, ne auditojmë zbatimin e politikave. Nëse unë si kryetar i KLSH në punën time



në këto vite do të kaloja në këtë fushë, riskoja pavarësinë e institucionit. Mund të kisha fituar disa kredite vetë, por nuk ishte mirë për institucionin". Bazuar në analizën vjetore, sipas kreut të KLSH-së, rezultoni se administrimi i pronës shtetërore ka peshën kryesore në dëmin që i bëhet buxhetit të shtetit, e ndjekur nga donaganat dhe prokurimet publike.

rrezikuar institucionin", tha Bujar Leskaj. Por një ndërhyrje nga vendi e ministrit Pandeli Majko solli reagimin e Berishës. "Ti Pandeli mos fol më mirë, se ty të largojnë dhe të kthejnë prapë", tha Berisha, teksa u referuar përplasjes së Majkos me Ramën seancën e para dy javëve, kur u votua ligji për Teatrin Kombëtar dhe për rrjedhojë ministri nuk votoi.

## LSI, Rama: Bijtë e të kuqve si etërit, 'minjtë' janë ringjallur

Deputeti i LSI, Luan Rama, bëri dje në Kuvend një përmblidhje të sistemeve në Shqipëri, nga përmbysja e komunizmit deri në ditët e sotme. Luan Rama ka treguar kohën kur njerëzit përmbysën sistemin komunist si dhe shpresën që kishin tek demokracia. "Bijtë e të kuqve do të vijojnë si etërit. Ajo përzjerje zelli dhe inati, herë i fshehtë e herë i hapur për etërit e kuq që s'patën fuqi dhe mend të ishin të përjetshëm, do t'i bëjë më dinakë dhe më të liq. Nga kundërshtarët e tyre që i urrejnë për vdekje, do të vjedhin idetë, projektet dhe dritë edhe sloganet e do t'i propagandojnë më mizorisht për t'i vënë ata në jetë, gjoja si amanete. Nuk jam unë njeri kundër komunistëve, jam komunistët kundër njeriut! Minjtë janë ringjallur!", - deklaroi z.Rama.

## INTEGRIMI NE BE

### VIZITA

Darina Tanushi

Presidentja e Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitarovic deklaroi dje në sallën e Kuvendit të Shqipërisë se, "konsensusi parlamentar dhe kombëtar për negociatat është shumë i rëndësishëm". Gjatë takimit me kreun e Kuvendit, Gramoz Ruçi, presidentja kroate u shpreh se "Kroacia është një vend partner dhe mik i sinqertë të Shqipërisë". "Ne do të vazhdojmë ta ndihmojmë Shqipërinë, në fazën e përgatitjeve për hapjen e negociatave me përvojën dhe arritjet tona, madje edhe duke shmangur gabimet tona. Konsensusi parlamentar dhe kombëtar për negociatat është shumë i rëndësishëm", nënvizoi Presidentja Kitarovic. Sipas znj. Kitarovic, kjo do të ndihmojë të gjithë qytetarët të kuptojnë rëndësinë, vështirësitë dhe kostot e këtij procesi. Znj. Kitarovic theksoi se reformat që keni ndërmarrë nuk janë reforma për BE-në, por për qytetarët shqiptarë, për të përmirësuar jetën dhe mirëqenien e tyre. Madje, ky është edhe qëllimi i integrimit evropian dhe i vetë BE-së. "Gjithashtu, duhet të keni parasysh se me përvojën në BE integrimi i vërtetë evropian nuk përfundon, por vetëm fillon. Prandaj do t'ju duhet të përgatisni një strategji të qartë për periudhën e pasanëtarësimit, i cili të parashikojë dhe përgatisë kushtet se si Shqipëria do të funksionojë si një vend anëtar i BE-së. Për këtë ne do t'ju ndihmojmë me përvojën tonë dhe ekspertët tanë. Parlamentari kroat dhe ekipet tona që kanë punuar për procesin e anëtarësimit do të japin kontributin e tyre për garantimin e hapjes së negociatave me Shqipërinë në qershor 2019", u shpreh Presidentja znj. Kitarovic. Kryetari i Kuvendit, Ruçi nga ana e tij vuri në dukje se Shqipëria ka marrëdhënie të shkëlqyera e miqësore me Kroacinë, të cilat bazohen të historia jonë e përbashkët, vlerat e përbashkëta, përparësia e përbashkët e politikës së jashtme, kontributi për një rajon të qëndrueshëm, paqësor dhe të begatë, si edhe vizioni i njëjtë për të ardhmen e Ballkanit Perëndimor në BE. Ai vlerësoi mbështetjen e fuqishme të Kroacisë në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë. Ruçi vuri në dukje se Kroacia përbën një përvojë për t'u marrë shembull, sa i përket procesit të integrimit evropian dhe ky model duhet e mund të ndiqet edhe nga Shqipëria. Presidentja znj. Kolinda Grabar-Kitarovic mbajti edhe një fjalë përshëndetëse në seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë. Ajo nënvizoi se: "Marrëdhëniet e shkëlqyera midis Kroacisë dhe Shqipërisë i kanë rrënjët

Kitarovic në Kuvend: Do t'ju ndihmojmë në fazën e përgatitjeve për në BE

# Presidentja e Kroacisë: Konsensusi kombëtar, i rëndësishëm për negociatat

"Shqiptarët sakrifkuan në luftën e Kroacisë me pushtuesit"



Presidentja e Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitarovic, dje në sallën e Kuvendit të Shqipërisë

#### DEKORATA

Pas dekoratës që i dha Presidenti i Republikës, presidentja kroate, Kolinda Grabar Kitarovic mori dje titullin "Qytetar Nderi" i Bashkisë së Beratit. Në fjalën e saj, ajo vlerësoi qytetin e Beratit si një thesar të çmuar të mbrojtur nga UNESCO. Kitarovic tha se lidhjet e Shqipërisë dhe të Kroacisë janë të ngushta.



Ceremonia e dëshme e përfundimit të bustit të Pjetër Arbnorit

#### SHKURT

#### Anëtarësimi në BE, Bushati: Shqipëria, rol në rritje për politikën e jashtme në rajon

Qeveria shqiptare mbetet e angazhuar për të përfshirë në nisma e projekte konkrete bashkëpunimi rajonal të gjitha grupet e interesit, sidomos të rinjtë, tani që nisi edhe procesi përgatitor për bisedimet për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Gjatë fjalës së tij në Kuvend për ratifikimin e marrëveshjes si vendi pritës ndërmjet Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati u shpreh: "Një prani më e shtuar e selive rajonale në Tiranë, jo vetëm flet qartë për një qëndrim më të balancuar të nismave në rajonin tonë, por është edhe dëshmi e pjekurisë së Shqipërisë". Ministri garantoj se qeveria do të mbështesë këto nisma fuqimisht jo vetëm në kuptimin politik, financiar e logjistik, por edhe si dëshmi e pjekurisë së Shqipërisë dhe rolit gjithnjë e më në rritje që Shqipëria ka për sa i përket politikës së jashtme në rajon. Kreu i diplomacisë shqiptare bëri me dije se shumë shpejt në Kuvend vjen për ratifikim edhe marrëveshja për selinë e Fondit të Bashkëpunimit Rinor Rajonal, një tjetër nisim rajonale me qëndër në Tiranë.

#### Vlahutin mbaroi mandatin, Luigi Soreca emërohet ambasadori i BE-së në Shqipëri

Luigi Soreca emërohet ambasadori i Bashkimit Evropian në Shqipëri. Ditën e sotme Përfaqësuesja e Lartë Federica Mogherini shpalli emërimet e 24 ambasadorëve në disa vende, mes tyre edhe në Shqipëri. Italiani Luigi Soreca do të zëvendësojë në Shqipëri Roman Vlahutin. Ai punon prej vitesh në rangje të larta në Bruksel dhe ka qenë i angazhuar me Shqipërinë gjatë procesit të liberalizimit të vizave. Luigi Soreca është Drejtor i Sigurisë në Komisionin Evropian. Ai është njohës i mirë i çështje të sigurisë, i legjislacionit në luftën kundër terrorizmit, krimin të organizuar, korrupsionit dhe krimeve të tjera të rënda, dhe ka punuar me EUROPOL dhe CEPOL. Veç liberalizimit të vizave me Shqipërinë ai ka udhëhequr këtë proces edhe me Marokun, Tunizinë apo me Federatën Ruse. Ai ishte përgjegjës për menaxhimin e Qasjes Globale ndaj Migrimit dhe Lëvizshmërisë si dhe për të tjera aspekte ndërkombëtare të migracionit. Si njohës i mirë i ligjit, ai vjen në Shqipëri në momentin e duhur, pasi sapo ka nisur zbatimin e Reformës në Drejtësi.

#### Fondi 230 mijë euro për pastrimin e bregdetit

## Kroacia e Shqipëria, bashkë për mbrojtjen e Adriatikut kundër ndotjes

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit ka nisur projektin për "Menaxhimin e ndotjes detare dhe bregdetare, për rritjen e sigurisë në det dhe porte, në përpunimin e ligjin dhe politikën detare të BE". Projekti i financuar nga qeveria kroate synon të zgjidhë nevojat për një platformë të koordinimit ndërinstitucional të sistemit shqiptar të gatishmërisë dhe reagimit, duke përfshirë burimet publike dhe private, që do t'u përgjigjen rasteve të emergjencave, derdhjeve të naftës, ose substancave të tjera të rrezikshme në mjediset detare. Gjatë prezantimit të projektit mori pjesë edhe Presidentja kroate, Kolinda Grabar Kitarovic, e cila vuri theksin në rëndësinë e parandalimit të fenomenit. "Çka është tepër e rëndësishme për Kroacinë dhe do të vazhdojmë ta mbështesim Shqipërinë dhe Malin e Zi dhe vendet e tjera që lagen nga Adriatiku, është menaxhimi i mbetjeve.



Sepse fatkeqësisht gjatë dimrit, rrjedha detare dhe era transporton mbetjet në brigjet tona", tha presidentja. Projekti do të nisë me një fond prej 230 mijë eurosh. Ndërsa drejtoreja e PNUD-it në Shqipëri theksoi se projekti u përgjigjet emergjencave mjedisore. "Lançimi i këtij projekti është tepër i rëndësishëm dhe synon të ndihmojë forcimin e kapaciteteve kombëtare dhe lokale për t'u përgjigjur emergjencave, derdhjes së vajit apo substancave të tjera të rrezikshme në mjedisin detar", tha Limya Eltayeb. Po ashtu dhe ministri Damian Gjilkuri ka vlerësuar nisimën duke vënë theksin te parandalimi i ndotjes mjedisore.

në historinë e përbashkët të luftërave kundër pushtuesve, në bashkëjetesën e shkëlqyer të komunitetit shqiptar në Kroaci, në përpjekjet e përbashkëta për zhvillimin dhe mirëqenien e popujve tanë, në arritjet dhe përpjekjet e përbashkëta për t'u integruar në NATO dhe BE, si edhe në përpjekjet për të

ndërtuar një rajon të begatë, të sigurt dhe paqësor. Shqipëria është një mike e Kroacisë dhe ka qenë e tillë kur për miq kishim nevojë dhe ata ishin shumë të paktë. Mjaft shqiptarë kanë sakrifkuar jetën e tyre për Kroacinë dhe Kroacia nuk e harron këtë. Kroacia i kushton një vëmendje të madhe stabilitetit,

sigurisë dhe begatisë së Evropës Juglindore dhe mbështet fuqimisht perspektivën evropiane të rajonit", tha ajo. Presidentja Kitarovic uroi Shqipërinë për vendimin e Këshillit Evropian, për përcaktimin e rrugës dhe datës së hapjes së negociatave dhe vuri në dukje besimin se Shqipëria do të vazh-

dojë në rrugën e reformave që ka ndërmarrë, duke nënvizuar sidomos reformën në drejtësi dhe procesin e vetëgut, i cili po kontribuon në rritjen e besimit tek institucionet gjyqësore si shtyllë e shtetit ligjor. "Evropa Juglindore është me rëndësi strategjike jo vetëm për BE-në, por për të gjithë këtë pjesë

të botës. Shqipëria është një partner i rëndësishëm strategjik dhe politik dhe kjo është e njohur edhe nga BE", nënvizoi Presidentja Kitarovic. Presidentja kroate u prit edhe nga kryeministri Edi Rama, i cili i shprehu falënderimet për mbështetjen e Kroacisë sa u përket negociatave me BE-në.



**JUSTINA ARBNORI**

Ndryshe nga vendimi në këshillin bashkiak që kaloi vetëm me votat e të majtëve, ceremonia e vendosjes së bustit bëri bashkë të majtë e të djathtë, ku ajo që preku më shumë ishte fjala e mbajtur nga e bija, Justina. "Shpresoj shumë që jeta dhe vepra e tij e tim eti të na frymëzojë të gjithëve ne që ta jetojmë jetën çdo ditë duke besuar në Zot dhe vlera, me dinjtet, pa kompromise dhe me sakrificë", - tha Justina Arbnori.



**Ndryshimet në ligj: Nuk përfiton brezi i tretë**

**Ish-të përndjekurit: Nisma antikushtetuese, do ta dërgojmë në gjyq**

Ish-të dënuar politik e konsiderojnë antikushtetuese Nismën e Ministrisë së Financave, e cila parashikon ndryshimin e ligjit dhe heqjen nga skema të përfutësve të brezit të tretë. Sipas ndryshimeve të propozuara parashikohet që në radhën e trashëgimtarëve do të mund të përfitojnë vetëm fëmijët e ish-të dënuarve dhe jo më nipërit dhe mbesat. Presidenti i Unionit mbarë kombëtar të ish-të përndjekurve dhe ish-të dënuarve, Besim Ndrejoni paralajmëron se do ta ankimojnë. "Në radhë të parë ministri duhet të njohë Kushtetutën e vendit, e cila me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, përcakton trashëgiminë e qytetarit dhe nuk mund ta përcaktojë një VKM e qeverisë. Do ta dërgojmë në gjyq ministrin dhe qeverinë për shkelje të Kushtetutës dhe pikërisht të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë", tha z.Ndrejoni. Përfaqësuesi i ish-të përndjekurve dhe ish të dënuarve politikë ngre si shqetësim edhe ecurinë e ndarjes së kësteve. "Problemi më madhor është se këtu nuk po punohet për dëmshpërblim. Më shumë është politizuar dëmshpërblimi, më shumë është bërë një fasadë e madhe sikur kjo qeveri ka dhënë 6-7 kaste. U ka dhënë 2 mijë vetëve 6 këste nuk i ka dhënë të tjerëve. D.m.th. këstin e tretë ka qe në vitin 2010 që nuk e marrin", tha z.Ndrejoni. Ndryshimet në ligj po bëhen për të shkurtuar kohën e dëmshpërblimit, pasi aktualisht trashëgimtarët kanë marrë vetëm dy këste dhe nëse bëhet një llogaritje atëherë do të duhen më shumë se 40 vjet për të përfunduar procesin.

Busti i "Mandelës shqiptare" bashkon të majtë e të djathtë, Ruçi: I dashur për të gjithë

**Pjetër Arbnori "kthehet" në Kuvend, e bija: Jetë pa kompromise**

*Mustafaj: Sërish do të ishte kundërshtar i Ruçit*

**Valentina Madani**

Dymbëdhjetë vite pas ndarjes nga jeta, Pjetër Arbnori ose siç njihet ndryshe Mandela i shqiptarëve, dje u "rikthye" sërish në Kuvend. Përrurimi i bustit të Arbnorit, i vendosur përpara selisë së parlamentit arriti t'i bëjë bashkë të majtë e të djathtë, të pakten për një orë. Fjalimet protokollare në këtë ceremoni u zëvendësuan nga ndjesa për harresën që politika i bëri ndër vite "Mandelës shqiptar". Ndryshe nga vendimi në këshillin bashkiak që kaloi vetëm me votat e të majtëve, ceremonia e vendosjes së bustit bëri bashkë të majtë e të djathtë, ku ajo që preku më shumë ishte fjala e mbajtur nga e bija, Justina. E bija e Pjetër Arbnorit, Justina u shpreh para pjesëmarrësve: "Shpresoj shumë që jeta dhe vepra e tij e tim eti të na frymëzojë të gjithëve ne që ta jetojmë jetën çdo ditë duke besuar në Zot dhe vlera, me dinjtet, pa kompromise dhe me sakrificë". Kryetari i Kuvendit, post të cilin Arbnori e mbajti për disa vite, vlerësoi rolin dhe figurën e Pjetër Arbnorit si njeriu që pavarësisht vuajtjeve që jeta i dhuroi mbeti njëri i dashurisë në drejtimin e parlamentit shqiptar. "Me hapin e tij të lehtë e përshkoi këtë shesh i qetë, por edhe i trazuar, i gëzuar, por edhe i trishtuar, shpresëplotë, por edhe i zhgënjyer, por kurrë nuk i mungoi atij dashuria për njerëzit. Pjetër Arbnori ishte një personalitet politik i vendosur, dinjitos dhe i respektuar, jeta vuajtjet ia derdhi lumë kurse lumturinë ia dha me kursim, ia dha me vonesë dhe ia mori shumë shpejt. Në drejtim të Kuvendit, Pjetër Arbnori mbeti njëri i dashurisë për njerëzit", deklaroi z.Ruçi. Ish-deputeti dhe shkrimtari Besnik Mustafaj vlerësoi rolin e Pjetër Arbnorit në politikën shqiptare, pa harruar se, nëse do të ishte në sallë, do të kishte qenë sërish kundërshtar i Gramoz Ruçit. "Faleminderit zotni Pjetër që u ktheve në shtëpinë tënde, tani e mbraja nuk do të na largohesh më. Ky parlament do të mbetet shtëpia e patjetërsueshme e tij. Ai ishte një burrë i pjekur dhe i ditur, i aftë ta zgjedhë



Bashkëshortja e Pjetër Arbnorit, Suzana, dje gjatë ceremonisë së përrurimit

**Rikthehet në PD, pas kritikave shtrëngon duart me Bashën**

**Ruli, kafe me Bashën e Berishën: S'ka rikthim pa mbjellë bahçen me pemë**

Dy prej themeluesve të PD, Genc Ruli e Besnik Mustafaj, janë rikthyer në selinë e Partisë Demokratike pas më shumë se njëviti për t'u takuar me Lulzim Bashën dhe Sali Berishën. Dy ish-funksionarët njihen si kritikë të Bashës, ndërsa Genc Ruli, në një prononcim të shkurtër për mediat nuk e përjashtoi mundësinë e rikthimit në politikë aktive. Që prej tërheqjes nga politika aktive 1 vit e gjysmë më parë Genc Ruli nuk ishte parë në selinë blu. Bashkë me Besnik Mustafajn ish-ministri demokrat ishte rreshtuar në grupin e të ashtuquajturve kritikë të Lulzim Bashës, por mesa duket koha ka sheshuar meritë e vjetra dhe mëngjesin e sotëm pika e takimit ishte zyra e liderit demokrat. "Biseduam të gjitha gjërat që mund të bisedoheshin në një takim informal", u shpreh Mustafaj. Kurse Ruli tregoi çfarë e rikthen në PD. "Nuk kam asnjë detyrim. Pa mbaruar bahçen dhe pa mbjellë pemët nuk kthehem në jetën aktive", u shpreh me ironi Ruli. "Nuk mendoj se kam aq shumë mend t'u jap këshilla të tjerëve kam eksperiencë sa për vete. Shkëmbim bisede mes miqsh, si i sheh ai si i shohim ne", theksoi z.Ruli. Sali Berisha nuk mungoi në takim që Lulzim Basha pati me dy prej themeluesve të PD, të cilët nuk ja kanë kursyer kritikën lidhshpirt demokrat pas hartimit të listave dhe humbjes së zgjedhjeve. Takimi në PD e dy ish-funksionarëve, erdhi pas ceremonisë së përrurimit të bustit të Pjetër Arbnorit në lulishten e oborrit të Kuvendit.

fjalën e duhur. Ishte pajtues, por jo në dëm të së vërtetës. Këshilla e Pjetër Arbnorit sot për ju deputetë dhe drejtues të partive politike do të kishte qenë: Jepuni mundësinë shqiptarëve të zgjedhin kush do i qeverisë nisur nga programet dhe jo nga individët. Ne e kishim këtu midis nesh, për afro 20 vjet Pjetër Arbnorin, Mandelën shqiptare dhe nuk ditëm ta ngremë në piedestal të gjallë, jo për ti bërë nder atij, por Shqipërisë. Nëse do ulej



**Majko fton Topallin të "bëhet" socialiste**

Përrurimi i bustit të Pjetër Arbnorit në lulishten përballë Kuvendit bëri bashkë familjarë e miq të ish-kryeparlamentarit dhe politikantë të të dyja krahëve, deputetë ose jo. Në këtë ceremoni kthehe për herë të parë edhe ish-kryeparlamentarja, Jozefina Topalli. Gjurma.al shkruan se Topalli më së shumti ndenji me socialistët se sa me demokratët. Ajo takoi fillimisht ministrin e Diasporës, Pandeli Majko, ish-ministrin demokrat Genc Ruli, kryetarin e Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj, ndërsa nguroi t'i bashkohet grupit të deputetëve demokrat që qëndronin në radhë e fundit. E ndërsa ceremonia po niste, ajo me shaka i ka thënë Majkos se ku do qëndronin dhe ky i fundit i ka kujtuar me humor se në radhë e fillimit ishin të gjithë socialistët. Dhe përgjigja e Topallit po me humor ka qenë se socialiste nuk bëhem.

**Dialogu**  
**Majko:** Jozefinë hajde këtu ...  
**Topalli:** Ku do qëndrojmë?  
**Majko:** Këtu para janë të gjithë socialistët.  
**Topalli:** Jo, jo, socialiste nuk bëhem dot ...

Presidenti i Republikës Ilir Meta u pa afër ish-kryeministrin Sali Berisha e mes tyre ndodhej kryeparlamentari Gramoz Ruçi. Në ceremoni është parë edhe kryedemokrati Lulzim Basha. Përveç doktorit afër tij kemi parë dy prej kritikëve Genc Rulin dhe Besnik Mustafajn, e pranishme ishte edhe Jozefina Topalli. Mes personaliteteve politike nuk munguan as kryebashkiaku Veliaj e ministrja e Arsimit Lindita Nikolla.

Taksat vendore, ja si mund t'i paguani 'online'

Tatimet paralajmërojnë qytetarët: Kujdes me detyrimet e prapambetura!

TAKSAT

Në kryerjen e kërkesave të ndryshme pranë D.P.T.T.V, bizneseve dhe qytetarëve nuk do t'u kërkohej asnjë dokument që mund të nxirret nga punonjësit e administratës.

kërkohej asnjë dokument që mund të nxirret nga punonjësit e administratës. Së shpejti njofton Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, të

gjithë subjektet dhe qytetarët do të mund të aplikojnë dhe të pajisen me vërtetim për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore përmes platformës elektronike e-Al-

bania. "Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore ka njoftuar, gjithashtu, të gjithë subjektet, të cilët rezultojnë debitorë ndaj Bashkisë Tiranë, të shlyejnë detyrimet brenda afateve të përcaktuara në nenin 89 i ligjit 9920/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të shmangur masat e mëtejshme. Mospagesa e detyrimit tatimor brenda afateve lig-



jore do të shoqërohet me marrjen e të gjitha masave për vjeljen e detyrimeve tatimore, të parashikuara nga kreu XI, neni 88 në vijim i ligjit 9920/2008 "Për procedurat tati-

more në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, paralajmërojnë ata "thuhet në njoftimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore.

Raporti i Komisionit European: Vendet kandidatë, probleme me huat


Kreditë e këqija, Shqipëria me nivelin më të lartë në rajon

Depozitat në Shqipëri u zgjeruan me 1%, në Maqedoni me 6%

Me gjithë masat që ka marrë Banka e Shqipërisë për uljen e nivelit të kredive të këqija, Shqipëria rënditet si vendi me nivelin më të lartë në rajon të kredive të pakthyera në afat. Sipas raportit të fundit të Komisionit European për vendet kandidatë, në tremujorin e parë të vitit 2018, niveli i kredisë me probleme (NPL) në Shqipëri mbeti stabil në 13.4% të totalit të huas, pas një tendence rënëse në 2017-n. Në Serbi, e cila dikur kryesonte në rajon, NPL-të kanë zbritur në 9.2%, niveli më i ulët i dekadës. Edhe Mali i Zi ka ulur huat me probleme në 7.3%. Të tre këto shtete, Shqipëria, Serbia dhe Mali i Zi, kishin deri dy vjet më parë treguesin e NPL-ve që i kalonte 20%, por pas strategjive që ndoqën për uljen e kredive me probleme, ky tregues u reduktua ndjeshëm, por me ritme më të larta në Serbi dhe Mal të Zi. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, 9.7% e huave janë të pakthyera në afat, në Maqedoni 6.5%. Në Kosovë, ky tregues është vetëm 3.1%, nga 8.7% që ishte në vitin 2013, sipas shifrave të publikuara nga Komisioni European.

DEPOZITAT DHE KREDITË

Ndërsa rritja e kredive dhe depozitave ka ngecur në Shqipëri në muajt e parë të këtij viti, e kundërta ka ndodhur



Burimi: Komisioni European

me rajonin, që ka parë një zgjerim më të shpejtë të sektorit bankar në raport me ne. Kredia ra me 0.1%, ndërsa depozitat u zgjeruan me 1% në tremujorin e parë në Shqipëri. Në Maqedoni, rritja e kredisë ishte 3.1% dhe e depozitave 6%. Në Mal të Zi, performanca e sistemit financiar ishte shumë më e mirë, me depozitat që u zgjeruan me 13.8% dhe kredinë me 11.8%. Në Serbi huat dhe depozitat u zgjeruan përkatësisht me 2.2 dhe 3.3%, në Bosnjë 5.3 dhe 10.4%. Në Kosovë rritja e

kredive i kalonte 10% dhe ajo e depozitave ishte 8.6%. Kursimet në sistemin bankar kanë shënuar në maj një tjetër rënie të fortë, sipas statistikave të publikuara nga Banka e Shqipërisë. Në fund të muajit maj, stoku total i depozitave në lekë dhe në valutë zbriti në 968 miliardë lekë, duke rënë me gati 10 miliardë lekë, ose 1% në krahasim me muajin e mëparshëm (70% e rënies erdhi nga tkurrja e kursimeve në valutë). Ky është niveli më i ulët i depozitave që nga korriku i vitit 2015.

EKONOMIA SHQIPTARE

Komisioni European në Raportin mbi zhvillimet ekonomike të vendeve kandidatë dhe potenciale në tremujorin e parë të 2018-s. Në përgjithësi, raporti e vlerëson pozitivisht ecurinë e ekonomisë, investimet e huaja, uljen e papunësisë, reduktimin e kredisë me probleme. Ecuria më negative, referuar raportit, ishte ajo e të ardhurave buxhetore. Totali i të ardhurave u rrit me 2% në tremujorin e parë të 2018-s, shumë më poshtë rritjes së të ardhurave të buxhetuara për periudhën (6.4%). Të vetme kategori të ardhurash që performuan më mirë se sa ishin buxhetuar, ishin kontributet e sigurimeve shoqërore. Borxhi publik (përfshirë grantet) u ul me 0.2% në tremujorin e parë. Niveli i borxhit ishte 69% e PBB-së në fund të marsit, nga 70.1% që ishte në fund të 2017-s. Sipas raportit tregu i punës reflektoi zhvillimet ekonomike. Në tremujorin e parë punësimin u rrit me 3.5% në krahasim me një vit më parë. Norma e papunësisë preku nivelin prej 13%. Megjithatë, papunësia të rinjtë mbetet ende shumë e lartë, edhe pse ka pësuar rënie prej pikut në 2015-n. Në tremujorin e parë, papunësia për grupmoshën 15-29 vjeç ishte 24.5%.

SHKURT

Deklarata e TVSH-së, 360 subjekte të vogla nuk kanë zbatuar afatin e tatimeve

Një numër i lartë i bizneseve të vogla i janë përgjigjur thirrjes së tatimeve për të kryer deklarimet deri më 16 korrik. Sipas të dhënave zyrtare rreth 11,340 subjekte që i përkasin fashës 2 deri në 5 milionë lekë, dorëzuan, pranë Administratës Tatimore, deklaratën e thjeshtuar të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar. Kjo shifër përbën rreth 97% të totalit të deklaratave të gëneruara nga sistemi, për tatimpaguesit e vegjël, të cilët mbartën detyrimin për të deklaruar dhe paguar TVSH-në. Sipas parashikimeve të administratës tatimore duhet që mbi 11.700 biznese të kryenin këtë deklaratë. Sipas ligjit në fuqi për bizneset që nuk kanë plotësuar deklaratën brenda afateve do të penalizohen me 5 mijë lekë për deklaratë. Për të gjithë biznesin e vogël që nuk mund ta plotësojnë vetë deklaratën ka qenë administrata Tatimore, nga data 1-16 korrik, që ofroi për 900 subjekte të biznesit të vogël asistencën e nevojshme për plotësimin e librave të shitjes dhe blerjes, si dhe plotësimin e deklaratës së thjeshtuar të TVSH-së. Për të gjithë personat që e plotësuan deklaratën me gabime nuk u aplikuan penalitete.

Biletat elektronike në transportin publik, MIE shpall rregullat

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka publikuar një udhëzim, i cili përmban kriteret për përzgjedhjen e subjektit që do të marrë të drejtën për prodhimin dhe shpërndarjen e biletave elektronike për transportin rrugor. Ky vendim duket se i hapë rrugë zhvillimit të një gare për biletat elektronike dhe aplikimin e tyre në shërbimet e transportit publik. Qeveria ka miratuar më parë edhe një udhëzim që përcaktonte biletat elektronikë do të realizohet përmes kartave plastike smart dhe përmes biletave elektronike prej letre me shirit magnetik. Fitimi i të drejtës së prodhimit dhe shpërndarjes së biletave elektronike do t'i mundësojë subjekteve të administrojnë sistemin e biletimit elektronik, për linjat urbane dhe ato ndërqytetase. Ndërkohë, MIE përcaktonte se forma e kontraktimit të subjekteve të treta është përmes koncesionit ose partneritetit publik privat. Kjo do të thotë se një institucion mund të shpallë një tender për biletat elektronike dhe kompania fituese do të paguhet në bazë të ofertës së tij, ose do të mbajë një tarifë mbi të ardhurat nga ky aktivitet. Të drejtën për të aplikuar në garë e kanë subjektet që plotësojnë kriteret e vendosura nga MIE: reputacion të mirë, qëndrueshmëri financiare, eksperiencë të ngjashme në Shqipëri apo vende të BE, si dhe të zhvillojë aktivitetin në Shqipëri.

**NJOFTIM ANKANDI**  
Shoqëria përmbarimore "BAILIFF SERVICE E. HOXHA" shpk njofton shpalljen e ankandit të III-të, për shitjen e pasurive të llojit:  
- Arë, me sip. 1.400 m<sup>2</sup>, zik 3235, ndodhur në Rrogozhinë Fshati Bishti i Zhurit, në pronësi të z.Emot Luan Meka. Ankandi i pasurisë fillon me grimin fillestar në vlerën 564,480 (pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e tetëdhjetë) Lekë.  
- Arë, me sip. 1.485 m<sup>2</sup>, zik 3235, ndodhur në Rrogozhinë Fshati Bishti i Zhurit, në pronësi të z.Emot Luan Meka. Ankandi i pasurisë fillon me grimin fillestar në vlerën 598,752 (pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) Lekë.  
Ankandi do të zhvillohet më datë 24.07.2018, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë Përmbarimore "BAILIFF SERVICE E. HOXHA" shpk, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.teléfono 0682029920, email: ebyrith@hotmail.com.

**SHPLLJE ANKANDI**  
Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përmbanues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rozova, Pall 64, Hyja 8, Ap.1, Tiranë, njofton se me datë 10.08.2018 ora 9<sup>h</sup>-16<sup>h</sup> me ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandi II për shitjen e pasurisë të paluajtshme Trulli me sipërfaqe 24,405.50 m<sup>2</sup> e ndodhur në rrugën "Ali Shkëqeli", Tiranë me Nr. pasurisë.9/609, Vullmi.20, Faqe.6, në pronësi të Shoqërisë BAU-CONSTRUCTION sh.p.k me vlerë fillestare në ankand 341.676.72 (Treqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e dy) EURO .  
Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**SHPLLJE ANKANDI**  
Datë 24.07.2018, Ora 16:00  
Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.  
Shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Enkeleza Novaku dhe dorëzantit Adriatik Novaku:  
"Trulli" me sipërfaqe 100 m<sup>2</sup> dhe "Ndërrëtesë" me 3 kate me sipërfaqe 90 m<sup>2</sup> secili, 2 kate të miratuara me Vendim për Laje Ndërrëtesë Nr. 22 datë 29.04.1996 të Këshillit Bashkiak Pogradec, nr. i pasurisë 4/106, zona kadastrale 8581, vol. 13, faqe 69, adresa: Lajga Nr. 1, Pogradec.  
Çmimi fillestar i ankandit të parë është në shumën 10.400.000 (djetë milionë e katërqind mijë) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë

Kryeregjistruesi: Më shumë sportele në hipoteka për bashkatdhetarët që vijnë me pushime

Ornela Manjani

# Veprimet me pronat, lista e dokumenteve për çdo ndryshim

## Hipoteka/ Tarifat për shitblerje, dhurim, regjistrim e verifikim

Zyrat Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të shtojnë sportelet dhe do të zgjasin oraret e shërbimit gjatë periudhës së verës. Lajmi është bërë i ditur nga Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Valdrin Pjetri, i cili bëri të ditur se ka gati planin e masave për t'i ardhur në ndihmë në një kohë rekord bashkatdhetarëve që kthehen në Shqipëri gjatë sezonit veror dhe kërkojnë shërbime pranë këtyre zyrave. Sipas kryeregjistruesit, do të ketë sportele të situara në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të Paluajtshme, por dhe orar më të zgjatur të shërbimit. "Janë orientuar të gjithë drejtorët tanë për marrjen e masave dhe kryerjen sa më shpejt të aplikimeve që vijnë nga qytetarët, kryesisht të emigrantëve që kthehen në atdhe për pushime", tha kryeregjistruesi gjatë një takimi në Vlorë. Pjetri u kërkoi qytetarëve që të denoncojnë korrupsionin dhe çdo formë abuzimi brenda zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. "I lutem qytetarëve që t'i drejtohen portaliit 'Shqipëria që duam' për çdo ankesë dhe prob-

lematikë që hasin në sportelet tona dhe ne menjëherë do të jemi aty për t'i dhënë zgjidhje qytetarëve, dhe për të marrë masat tona për punonjësën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, i cili krijon pengesën", tha kryeregjistruesi Pjetri. Regjistrimet Regjistrimi i kontratave të shitjes, të dhurimit të heqjes dorë nga prona, regjistrimi i kontratës së shkëmbimit apo akti i trashëgimisë, shoqërohen me një sërë dokumentacioni, i cili duhet të jetë i plotësuar në momentin që pronari i një pasurie do të kryejë një veprim me të te noterit. Janë 51 veprime që kryhen me pronësi nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. "Gazeta Shqiptare" boton të plotë listën dhe shërbimeve dhe koston për çdo



veprim me pronën.

### TARIFAT

Regjistrimi i akteve materiale që lidhen ndërmjet zhvilluesit të pronës dhe pronarëve të pasurisë apo me subjektet e treta kusht-

ton 3500 lekë. Ndërsa regjistrimi i të gjitha kontratave, për shitje, dhurim heqje dorë nga pronësia, shkëmbim, dhënie me qira apo akt trashëgimie do të kushtojnë nga 700 lekë deri

në 3500 lekë. Konsultimi i kartelës së pasurisë dhe të dhënave të tjera të pasurisë së paluajtshme do të ketë një tarifë prej 700 lekësh. Ndërsa verifikimi online i gjendjes juridike të pronësish në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme do të ketë tarifën 600 lekë. Sipas kryetares së Dhomës së Noterisë regjistrim i kontratës së shitjes, kontratës shkëmbimit dhe kontratës së dhurimit me rezerve/kusht të pasurisë së paluajtshme do të kushtojë 900 lekë. Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës për kredi me vlerë deri në 1.000.000 lekë do të ketë një tarifë prej 7500 lekë.

### DOKUMENTET

Sipas listës së Hipotekës për regjistrimin e kontrat-

ave të shitjes së pronës duhet dokument identifikimi, kontrate shitje, deklarata materiale, vërtetim nga organi i njësisë vendore mbi përbërjen e familjes, certifikatë e gjendjes familjare dhe deklarata e anëtarëve të familjes bujqësore për zgjedhjen e një përfaqësuesi të ri të familjes bujqësore. Ndërsa për lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale duhet: harta treguese e pasurisë, planrilevimi, kartela e pasurisë dhe dokument identifikimi. Ndërkohë që për regjistrimin apo fshirje të hipotekës ligjore duhet të personi i interesuar të ketë: vendim gjykatë për fshirje, deklarata materiale, dokument identifikimi, vendim gjyqësor ose akt material për vendosjen e hipotekimit, kartela e pasurisë (kopje) dhe harta treguese e pasurisë.

Nr	Lloji i shërbimit	Tarifa (leke)	Komponente përqipafje e tarifës	Motiv ligjor për marrëdhinë me ZVRPP (leke)	Kod i shërbimit	Motiv max. i procedurës
1	Regjistrimi i akteve materiale që lidhen ndërmjet zhvilluesit të pronës dhe pronarëve të ttrallit apo me subjektet e treta.	3,500	0	0	R1	5
2	Regjistrimi i kalimit të pronësish me anë të ligjit, me vendim të gjykatës, apo të një akti administrativ.	3,500	10%	30	R2	7
3	Regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të fituar me parashkrim fitues.	3,500	10%	30	R3	5
4	Regjistrimi i aktit për kalimin e pronësish nga përbaruesi gjyqësor.	3,500	10%	30	R4	5
5	Regjistrimi i akteve me të cilat krijohet një shoqëri apo një subjekt tjetër i së drejtës, që ka në pronësi pasuri të paluajtshme apo gëzon të drejtë të tjera reale.	3,500	10%	30	R5	8
6	Regjistrimi i kontratave të shitjes.	3,500	10%	30	KP1	2
7	Regjistrimi i kontratës së dhurimit.	3,500	10%	30	KP2	2
8	Regjistrimi i deklarimit për heqje dorë nga pronësia.	800	10%	30	KP3	2
9	Regjistrimi i kontratës së shkëmbimit.	3,500	10%	30	KP4	7
10	Regjistrimi i kontratës së qirasë apo nënqirasë.	3,500	10%	30	B1	2
11	Regjistrimi i titujve " në përdorim".	3,500	10%	30	B2	5
12	Regjistrimi i aktit të trashëgimisë.	700	10%	30	KP5	7
13	Kopje të vërtetura të dokumenteve tekniko-ligjore, në të cilat bazohet regjistrimi i pasurive të paluajtshme / faqe.	200 lek/faqe	0	0	I1	3
14	Konsultimi i kartelës së pasurisë së paluajtshme.	700	0	0	I2	3
15	Verifikim online i gjendjes juridike të pronësish dhe të dhënave të tjera të pasurisë së paluajtshme.	600	0	0	I7	1
16	Informacion zyrtar i pasurisë për individët dhe Institucionet.	700	0	0	I3	3
17	Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale.	1,000	0	0	I4	2
18	Lëshim kopje kartele të pasurisë.	1,000	0	0	I5	5
19	Lëshim vërtetimesh (negativ/pozitiv).	300	0	0	I6	1
20	Dhënie e informacionit koordinativ për çdo pasuri të paluajtshme.	1,000	0	0	I8	2
21	Lëshim certifikate pronësie.	1,500	0	0	I1	5
22	Lëshim vërtetim pronësie.	1,500	0	0	I2	5
23	Lëshimi i certifikate të re kar ka humber apo është dëmtuar certifikata e marrë pa përshirë afatin ligjor 15 ditor të publikimit /afshimit).	800	0	0	I3	5
24	Regjistrim i vendimit gjyqësor për vendosjen e masës së sigurimit të padisë.	900	0	0	I33	2
25	Regjistrim i kërkesës së padisë.	900	0	0	I34	2
26	Regjistrim i aktit material për pezullimin e veprimeve të regjistrimit.	900	0	0	I4	2
27	Regjistrim i ndryshim / shuarje Servituti.	900	10%	30	I6	4
28	Regjistrim i kontratës së shitjes, kontratës së shkëmbimit dhe kontratës së dhurimit me rezervë / kusht të pasurisë së paluajtshme.	900	0	0	I37	3

29	Regjistrim i të drejtës së paraboljes.	900	10%	30	B8	3
30	Regjistrim i prokurës.	900	0	0	B9	2
31	Korrigjim gabimesh në kartelë.	700	0	0	K1	8
32	Korrigjim gabimesh në hartën kadastrale.	700	0	0	K2	10
33	Korrigjim gabimesh në certifikatën e pasurisë së paluajtshme.	700	0	0	K3	8
34	Kërkesë për regjistrimin e bashkimit, ndarjes apo pjesëtim të pasurisë së paluajtshme.	700	0	0	R6	15
35	Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës, për kredi me vlerë 1.000.000 lekë si dhe kopje kartele brenda këtij afati.	7,500	10%	30	B10	2
36	Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës, për kredi me vlerë 1.000.000 - 10.000.000 lekë si dhe kopje kartele brenda këtij afati.	15,000	10%	30	B11	2
37	Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës, për kredi me vlerë mbi 10.000.000 lekë si dhe kopje kartele brenda këtij afati.	25,000	10%	30	B12	2
38	Regjistrim apo fshirje e kontratave të tjera të hipotekës si dhe kopje kartele brenda këtij afati.	1,000	10%	30	B13	2
39	Regjistrim apo fshirje e hipotekës ligjore.	1,000	10%	30	B14	2
40	Regjistrim i Aktit të Bashkëpronësisë për objektet në bashkëpronësi të detyrueshme.	5,000	0	0	R7	10
41	Regjistrim i objekteve të legalizuara.	5,000	10%	30	R8	10
42	Regjistrim fillestar i pasurisë së paluajtshme pa rilevim azhormin nga ZRPP.	5,000	0	0	RF2	15
43	Regjistrim fillestar i pasurisë së paluajtshme me rilevim e azhormin nga ZRPP.	8,000	0	0	RF1	15
44	Regjistrim fillestar i veçantë i pasurive të paluajtshme në zonat rurale ( pa përshirë afatin ligjor 45 ditë).	30,000	0	0	RF3	15
45	Kalim i regjistrimit nga regjistrat hipotekore në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, para ose pas përfundimit të regjistrimit fillestar.	1,000	0	0	RF4	15
46	Regjistrim i lejes së ndërtimit.	1,000	10%	30	R9	10
47	Regjistrim i përkohshëm i Karabinasë.	6,500	10%	30	R10	15
48	Regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja.	6,500	10%	30	R11	15
49	Regjistrimi i marrëveshjeve dhe akteve lidhur me kufijtë e pasurive të paluajtshme.	2,500	0	0	R12	15
50	Ndryshim kufiri.	700	0	0	R13	15
51	Saktësim i kufijve të pasurisë.	2,500	0	0	R14	15

"E qëlloi Agron Tufa. I morëm varësen e floririt, orën 'Rolex' dhe paratë"

# Fushë-Krujë, Kejsi Hysa u ekzekutua dhe u gropos në parcelën me kanabis

## Bashkëpunëtori në krim, Hysni Ramaj: Më kërkoi 15 mijë euro për sasinë e hashashit që e humba

Dorjana Bezat

### FUSHË KRUIJË

Pak ditë pas gjetjes së trupit të pajetë të 34-vjeçarit, Kejsi Hysa nga fshati Gjorm i Kurbinit janë zbardhur detaje të reja në lidhje me ngjarjen e rëndë të ndodhur më 5 korrik të këtij viti. Mësohet se i riu nuk është vrarë me plumb në kokë për paratë e dhëna me fajde, por për drogë dhe se u varros në një parcelë me hashash. Këto detaje i ka dhënë vetë bashkëpunëtori në vrasje Hysni Ramaj, ndaj të cilit Gjykata e Krujës vendosi dy ditë më parë masën e sigurisë "Arrest me burg".

Gjatë deklaratimit në polici, 31-vjeçari Ramaj (pronar i një mobilierie) tregoi se konflikti mes Kejsi Hysës dhe tij ka ndodhur, sepse ky i fundit i kishte lënë në ruajtje 50 kg kanabis, sasi të cilën autori e kishte humbur. Për sasinë e kanabisit të humbur, Hysa i kërkoi 15 mijë euro dhe për t'ia kthyer e kërcënto Ramajn se do i merrte shtëpinë e gjithçka kishte. "News 24" ka arritur të zbardhë detaje nga krimi i



Viktima Kejsi Hysa

rëndë. Në rrëfimin para policëve, Ramaj ka thënë se ditën e ngjarjes së bashku me Agron Tufën po punonin tek një parcelë me hashash, e cila ndodhet në një vend të shpyllëzuar pranë varrezave të fshatit Shelqet. Kanë telefonuar Kejsi Hysën dhe i kanë thënë të vijë të marrë borxhin. Një orë pas telefonatës Kejsi mbërriti tek ata me makinën e tij "Golf 5", me ngjyrë gri. Ramaj i ka dorëzuar Hysës 1 milion lekë të

vjetra dhe i ka thënë se pjesën tjetër të parave nuk e kishte. Kjo ka sjellë debat mes tyre dhe Kejsi Hysa i ka ofenduar 2 kushërinjtë. Po sipas rrëfimit të Ramajt, 34-vjeçari e ka kërcënuar atë me pistoletë duke e drejtuar të hyjë në brendësi të parcelës me hashash. Gjithashtu, Hysni Ramaj pohoi para uniformave blu se ka ecur para, tek rrugica që hyr për në parcelë, e cila është rreth 3-4 metra dhe sapo është futur në par-

celë ka dëgjuar një të shtënë dhe më pas ka parë Agronin me një pushkë 20-she në dorë. Ndërsa, Kejsi kishte rënë në tokë rreth 2 metra larg tij, te rrugica që të çonte në parcelë. Pasi janë qetësuar bashkë me Agronin kanë vendosur që ta groposnin 34-vjeçarin tek parcela e hashashit. Me veglat e punës, ata kanë hapur një gropë. Fillimisht e kanë kontrolluar se çfarë kishte me vete Kejsi, të cilit i kanë gjetur: një varëse floriri, një orë dore, një çantë supi ku kishte rreth 5.800 euro, si dhe pistoletën që e kishte në dorë. Po kështu në xhepa kishte dhe dy telefona të thjeshtë të markës "Samsung" e "Nokia". Të gjitha këto sende ia kanë marrë dhe trupin e pajetë të viktimites e kanë groposur. Pistoletën e Kejsit e kanë hedhur në ferra afër vendit ku kanë hedhur pushkën 20-she të Agronit. Eurot e viktimites i kanë ndarë përgjysmë. Pjesën e vet, Hysni ia ka dhënë një personi që ia ka pasur borxh, ndërsa tek muri i banesës së tij ka futur varësen, orën "Rolex" të viktimites. Kejsi Hysa u zhduk pa lënë gjurmë më 5 korrik dhe u gjet i pajetë i groposur pranë varrezave të fshatit Shelqet 9 ditë më vonë.



### "Pesë familje mafioze shfrytëzojnë Velipojë"

## Media belge: Krimineli më i kërkuar, Safet Rustemi, fshihet në Shkodër

**BELGJIKË** - Në një artikull të medias belge "Le dernière heure" që mban datën 18 korrik përmendet emri i Safet Rustemit, i cili thuhet të jetë një nga kriminelët shqiptarë më të kërkuar në Belgjikë dhe që sipas tyre, dyshohet se fshihet pikërisht në Velipojë. Ky person, siç theksohet shkrimin është parë në Shkodër në terracën e një klubi, ditën kur në këtë qytet ndodhi vrasja e dyfishtë e ish-efektivit Boran Bërçana dhe bashkëjetueses së tij Silvana Ndoci. "Këtë fundjavë krimineli u pa në terracën e një klubi. Rustemi u pa në kohën kur Shkodra u trondit nga vrasja e një çifti. Boran Bërçana dhe bashkëjetuesia e tij, u vranë në sytë e fëmijës me 23 plumba", - theksohet shkrimin. Ndër të tjera, qyteti i Shkodrës, cilësohet ndryshe si një Palermo e re, ndërsa Velipoja e plazhet e saj siç thuhet në shkrimin kontrollon nga 5 familje mafioze. Sipas "Le dernière heure", Safet Rustemi shfrytëzonte një plazh në Velipojë me kapacitet 620 shtretër dhe shezlongë. Nga ana tjetër ai rezultoi të jetë një nga personat më të kërkuar në Belgjikë. 33-vjeçari ka marrë një dënim me 9 vite burg, për akuzat për drogë, tentativa për vrasje dhe vjedhje me dhunë, ndërsa dyshohet dhe si i përfshirë në zhdukjen e dy shqiptarëve në Belgjikë. "Emri i njerit prej kriminelëve më të kërkuar të Belgjikës ndodhet në një hartë plazh të Adriatikut. Ne morëm planet e pushtimit të plazheve të Velipojës. Afër Shkodrës në Shqipëri dhe Veriut, Velipojë është një nga plazhet më të bukura të Adriatikut. Dhe këtu, në këtë nivel, papritur, lexojmë emrin Safet Bajri. Emri i përdorur nga Safet Rustemi, një prej kriminelëve më të kërkuar në Belgjikë", - theksohet në shkrimin. "5 familjet e më të fortëve të Shkodrës shfrytëzojnë Velipojë. Safet Rustemi shfrytëzonte 620 shtretër plazhi dhe shezlongë. Safet Bajri zë një vend qendror në plazhin e Velipojës. 5 familjet e më të fortëve të Shkodrës shfrytëzojnë Velipojë", - shkruhet për Rustemin. Avokati i tij, Sven Mary nuk ka reaguar as pas interesimit të kësaj gazete. "Kontaktua me avokatin e Safet Rustemit në Belgjikë. Kontaktua me avokatin në dënimin e klienti i tij është në Shkodër. Avokati i Safet Rustemit nuk ka pranuar të reagojë", thuhet ndër të tjera në shkrim.

### SHKURT

#### Dy automjete përplasen me makinën e policisë në Korçë, plagoset efektivi

**KORÇË** - Një aksident automobilistik u shënuar ditën e djeshme në aksin rrugor Korçë-Devoll. Mësohet se në aksident janë përfshirë dy automjete si dhe makina e policisë. Si pasojë kanë mbetur të plagosur drejtuesi i mjetit tip "Volkswagen" si dhe punonjësja e policisë. "Më datë 18.07.2018, jemi njoftuar se në aksin rrugor Korçë-Devoll, në afërsi të fshatit Plasë, janë përplasar mjetet tip "Volkswagen" me targa K00456B me mjetin tip "BMË" me targa të huaja HBA3137". Nga përplasia e tyre, është përfshirë në aksident edhe një mjet i Policisë Rrugore, i cili ishte i pozicionuar jashtë rrugës. Për pasojë është plagosur lehtë drejtuesi i mjetit tip "Volkswagen" si edhe ka marrë dëmtime të lehta një punonjëse e Policisë Rrugore, të cilët po marrin ndihmë mjekësore në spitalin e Korçës, jashtë rreziqut për jetën. Dyshohet paraprakisht se shkak i aksidentit të ketë qenë shkelja e rregullave të qarkullimit nga ana e drejtuesit të mjetit tip "Volkswagen". Grupi hetimor po punon për sqarimin e rrethanave dhe shkakut të aksidentit", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

#### Ushtri dhunë ndaj babait dhe gjyshes, përfundon në pranga 23-vjeçari

**GJIROKASTËR** - Policia e Gjirokastrës ka arrestuar një 23-vjeçar, pasi ka ushtruar dhunë fizike ndaj gjyshes dhe babait të tij. "Nga specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimit në Komisarriatin e Policisë Gjirokastrë u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit: Steljo Rizvo, 23 vjeç, banues në Gjirokastrë. Arrestimi i këtij shtetasi u bë pasi në banesë ka ushtruar dhunë fizike ndaj gjyshes M.R.R, 67 vjeçe dhe të atit V.R, 47 vjeç. Fizikisht në ngarkim të këtij shtetasi i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë për veprimet të mëtejshme, për veprimet penale "Dhuna në familje", thuhet në njoftimin e policisë.

**DURRËS** - Avokati i njohur, Ilia Ilia është dhunuar dhe nga persona ende të paidentifikuar para gjykatës së Durrësit dhe për pasojë ka përfunduar në spital. Mësohet se ai sapo kishte përfunduar nga një seancë gjyqësore, kur është përballur me dy persona, me të cilët është konfrontuar fizikisht. Më datë 19.07.2018, rreth orës 10:45, në afërsi të prokurorisë është goditur me sende të forta nga dy persona shtetasi I.I. me profesion avokat, i cili ndodhet në spital jashtë rreziqut për jetën. Grupi hetimor po punon për identifikimin e autorëve dhe zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë së qytetit bregdetar. Ndërkaq, avokati ka thënë se ishin dy persona që e dhunuan, të cilët sipas tij janë udhëzuar nga prokurori Arjan Ndoj. "Prokurori Arjan Ndoj ka futur njerëz për të

## Dhunohet para gjykatës avokati Ilia Ilia: Dy agresorët i futi prokurori Arjan Ndoj



goditur nga ky dhe personi tjetër që erdhi. Dje (të mërkurë) në seancë gjyqësore më kanosi prokurori", - u shpreh Ilia Ilia. Gjithashtu, avokati i njohur sqaroi se një ditë para ngjarjes ka debatuar me prokurorin në fjalë. Në debat e sipër, mësohet se prokurori i ka thënë Ilia: "Do bëhesh pishman për këto që the". "Kur po debatonim me prokurorin Ndoj, i ktheva një përgjigje që unë nuk jam katundar si

ti. Ai mu përgjigje se për këtë fjalë që the sot do pendohesh shumë shpejt. Njeri ka qenë shoqëruar i Arjan Ndojës. Banda që ky ka lidhje si prokuror vodhi prokurorinë e Durrësit, ata që rrahën libanezin për tokën. Është po ky grupim që hetohet nga prokuroria e Durrësit", - u shpreh për GSH, avokati Ilia Ilia. Ai ka mbrojtur grupin e Shijakut dhe ka qenë edhe avokat i Lul Berishës.

Përmbasuesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shifje në aneknd pasurine :

"Toke Are me sip 865 m2, me Nr pasurije 131/86 Zona kadastrale nr 1896, Votumi 9, faqe 44 , me vendndodhje Grude e re Shkoder .

2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Aneknd për pasurinë e sipërpershkruar, është në vlerën 302,400 (Treqinda e dy mijë e katërqinda ) Lekë .

Shifja e pasurisë do të behet ( zhvillohet ) me date 27.07.2018 ora 16.16 në zyrën e përmbasuesit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko , Përballë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkoder . Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të anekndit 10 % të vlerës si garanci në Bankën BKT dega Shkoder me nr logarie 41064051.



**TIRANË** - Pas skandalit me anëtarin e Gjykatës së Lartë, Admir Thanza, i cili kishte fshehur një dënim për vjedhje të kryer në Itali, prokuroria shqiptare ka dërguar një letërporosi në shtetin fqinj. Letërporosia në fjalë për gjyqtarin që s'ka kaloi vetëgjyqjen dhe u shkarkua nga detyra (fshehu dhe pasurinë) është kërkuar për të mësuar detajet mbi vjedhjen që u dënua Thanza si dhe rrethanat në të cilat u krye vepra penale. Gjithashtu, mësohet se prokuroria ka kërkuar të dhëna edhe në lidhje edhe faktin nëse ka persona të tjerë të përfshirë në atë ngjarje. Procesi i vetëgjyqjes zbuloi se gjykatësi i lartë ishte dënuar në Itali me 40 ditë burg për vjedhje

## Skandali, vetëgjyqja shkarkoi 50-vjeçarin Admir Thanza

### Gjyqtari i lartë fshehu dënimin për vjedhje në grup, prokuroria dërgon letërporosi në Itali

#### DEKLARATA E THANZËS

Gjatë seancës dëgjimore në KPK, gjyqtari Admir Thanza deklaroi se vjedhjen e kishte kryer kunata e tij, por ai e mori përsipër për të ndihmuar nipin e tij të sëmurdë që po kurohej në Itali, pasi vuante nga një sëmundje e rëndë. Ka qenë asistenca e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, ajo që ka ndihmuar në zbulimin e këtij dënimi të padeklaruar nga Thanza.

në bashkëpunim, në vitin 1999. Thanza nuk e kishte deklaruar në formular këtë dënim. Në lidhje me këtë rast, ai deklaroi para trupës së

KPK se vjedhjen e kishte kryer kunata e tij, por ai e mori përsipër për të ndihmuar nipin e tij të sëmurdë që po kurohej në Itali, pasi vuante

nga një sëmundje e rëndë. Ka qenë asistenca e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, ajo që ka ndihmuar në zbulimin e këtij dënimi të padeklaruar nga Thanza. Një ditë pas përballjes me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, Prokuroria e Përgjithshme nisi hetimet ndaj tij. Admir Thanza do të hetohet për akuzën e falsifikimit të formularit të vetëdeklarimit. Hetimi ka nisur nga Seksioni i Dekriminalizimit në organin e



Anëtar i Gjykatës së Lartë, Admir Thanza

akuzës. Prokuroria do të sekuestrojë nga Komisioni i Vetëgjyqjes të gjithë dokumentacionin që u prezantua në seancën dëgjimore ndaj Thanzës. Burimet sqaruan se duhet të pritet vendimi i KPK që të vendoset nëse bëhet fjalë vetëm për falsi-

fikim të formularit të vetëdeklarimit, apo edhe vepra të tjera penale si korrupsion etj. Kjo do të vlerësohet pasi të administrohen të dhënat nga KPK dhe ILDKPI dhe më pas do të vendoset se cila prokurori do të hetojë dhe për çfarë vepra penale.

Prokuroria: Nën sekuestro janë vënë biznese, apartamente, toka, automjete dhe llogari bankare

# Krimet e Rënda sekuestrojnë pasurinë e Çilotajve

Dyshohet se janë vënë nga aktivitetet kriminale brenda e jashtë vendit

**TIRANË**

Prokuroria e Krimeve të Rënda ka vendosur sekuestro mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të shtetasve Shpëtim Çilotaj, Vladimir Çilotaj, Agur Çilotaj dhe Jonida Çilotaj nga Fieri, pasi dyshohet se janë vënë nga aktivitetet kriminale jashtë vendit. Ndër pasuritë e sekuestruara janë apartamente, toka dhe automjete. Fillimisht çështja ndaj Çilotajve ishte nën hetim nga prokuroria e Fierit, ndërsa gjykata e këtij rrethi kishte vendosur sekuestro më parë, por tashmë Prokuroria e Krimeve të Rënda që ka marrë çështjen në dorë në kuadër të ligjit antimafia eliminon çdo rrezik që mund të sillte rimarrjen e pasurisë nga të akuzuarit.



#### NJOFTIMI I PROKURORISË

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë

për Krimet e Rënda ka vendosur sekuestro mbi pasuritë e luajtshme/të paluajtshme të shtetasve Shpëtim

Çilotaj, Vladimir Çilotaj, Agur Çilotaj dhe Jonida Çilotaj.

Procedimi pasuror ka filluar mbi bazën e informacionit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier për shtetasit Shpëtim dhe Vladimir Çilotaj të përfshirë në aktivitetet kriminale, për të cilat janë dënuar në Shqipëri, Belgjikë dhe Greqi për veprat penale "Vjedhje" parashikuar nga neni 134/2 K.Penal, "Trafikimit të mjeteve motorike", parashikuar nga neni 141/a K.Penal, "Tregtimit të mallrave kontrabandë dhe për mallra akcize", parashikuar nga neni 76 K.Penal si dhe për vepra të tjera penale. Çështja u kalua në Prokurorinë për Krimet të

Rënda në kuadër të ligjit antimafia dhe Urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.106, datë 18.05.2010 "Për bashkërendimin e raporteve mes Prokurorisë të Rretheve Gjyqësore dhe Prokurorisë për Krimet të Rënda" (pika 3).

Në bazë të nenit 3/1/c të ligjit nr.10192 dt.03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundrejt pasurisë", mbi kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet të Rënda është vendosur sekuestro mbi pasuritë e luajtshme/të paluajtshme të shtetasve Shpëtim, Vladimir, Agur, Jonida Çilotaj, si më poshtë:

- Pasuritë e subjektit Agur Çilotaj.
- Në Fier, Njësi (Studio Piktori), me sip.40 m2.
- Apartament banimi 91.25 metër katrorë në Sarandë.
- Apartament 89.29 metër katrorë.
- Tokë truall 2721 metër katrorë, në Shkallnuar, Durrës dhe tri ndërtesa sociale 509 metër katrorë, total 1500 metër katrorë ndërtim.
- Pasuritë e subjektit Vladimir Çilotaj:
- Apartament 98 metër katrorë.
- Truall 500 metër katrorë në Golem.
- Pasuritë (ndërtim i paligjshëm) e shtetasit

Vladimir Çilotaj, për të cilat ka aplikuar në zyrën e ALUIZNI-it Fier.

- Pasuritë e shoqërisë "Çilotaj Group Ltd" shpk:
  - Godinë 290.6 m2, në emër të "Çilotaj Group Ltd".
  - Godinë 290.6 m2.
  - Truall 6134 m2 truall dhe 2460.2 m2 ndërtesë.
  - Truall 3020 m2 në emër të "Çilotaj Group".
  - Truall 2000 m2, Golem.
  - Apartament 98 m2.
  - Prona e llojit apartament 64.60 m2.
  - Prona e llojit apartament 98 metër katrorë.
- Pasuritë e shoqërisë "Ladi 2008" sha:
  - Pasuria e llojit Arë 6000 m2.
- Pasuria godinë banimi dhe shërbimi 9 kate në lagjen "Hajro Çakëri", Vlorë.

- Pasuritë e subjektit Jonida Çilotaj
  - Pasuria 82 metër katror, apartament.
  - Sekuestrimin e sendeve të luajtshme:
    - Të gjitha asetet, kapitalet, të drejtat dhe çdo interes pasuror, përfshirë edhe llogaritë bankare aktive të subjektit tregtar "Çilotaj Group Ltd".
    - Të gjitha asetet, kapitalet, të drejtat dhe çdo interes pasuror, përfshirë dhe llogaritë bankare aktive të subjektit tregtar "Ladi 2008".
    - Tri automjete në pronësi të Vladimir Çilotajt.
    - Automjet në pronësi të Jonida Çilotajt.
  - 12 automjete në pronësi të subjektit tregtar "Çilotaj" sh.p.k.
  - 15 automjete në pronësi të subjektit "LADI 2008" sha.

Sekuestrimi i disa llogarive bankare në disa banka të subjekteve të mësipërme.

United Nations Development Programme

**TENDER ANNOUNCEMENT**

Subject: Request for Quotation - Furniture for Multifunctional Community Centre in Shkodra City

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive quotations from interested companies who wish to be considered for the provision of the below mentioned furniture's.

Furniture for Multifunctional Community Centre in Shkodra City - ESERE

Companies will be selected in accordance with pre-established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope and with clearly marked for "UNDP - Economic and Social Empowerment for Roma and Egyptians - ESERE" to the address below.

For more details please refer to the link below:

<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement.html>

Relevant Dates: All interested companies should provide their application in the following address, not later than August 03, 2018, 14.00 hrs.

Any request for Clarifications must be sent to the following e-mail address: [procurement.al@undp.org](mailto:procurement.al@undp.org)

Address for Communication:

UN House Albania  
Str. "Skenderbeu", Gurten Building, 2<sup>nd</sup> Floor  
Tirana, Albania  
Tel.: + (355) 4 2 276 600  
Fax: + (355) 4 2 234448

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
Zyra përbarimorë "Best 2010"

**SHPALLJE ANKANDI**

Më datë 17 gusht 2018 nga ora 08.00-ora.16.00 tek kjo zyre përbarimorë do zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë nr.5856, vol 17, fq 3 të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës. Truall që ka sipërfaqen prej 600 m<sup>2</sup> kuftohet sipas një marrëveshje sipërmarje.

Prona është e vëllëzërve, z.Arben e z.Shkëlqim Riza Brameta

Cmimi fillestar më të cilin hapet ankandi do të jetë 54150000 lek.

Cmimi mund të llogaritet edhe në euro sipas kursit të këmbimit ditor.

Oftuesit duhet të kenë depozitur në llogarinë e zyrës përbarimorë 10% të cmimit fillestar.

Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000  
E-mail: [best2010@perbarues.al](mailto:best2010@perbarues.al), web: [www.perbarues.al](http://www.perbarues.al)

Autoriteti: Raportoni çdo rast, mos merrni mallra pa kupon tatimor

# Alarmi nga falsifikimi i pijeve në verë

*Ilollari: Produktet e falsifikuara shkaktojnë pasoja të rënda në shëndet*

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka ngritur alarmin për falsifikimin e pijeve dhe futjen e tyre kontrabandë. Në një njoftim për shtyp, doganat bëjnë thirrje që të bëhet kujdes me blerjen e produkteve pa pullën fiskale, pasi dëmtojnë jo vetëm buxhetin e shtetit, por edhe shëndetin e konsumatorëve. Zyrtarë të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit sqarojnë se pavarësisht masave të marra nga autoritetet, sërish në treg qarkullojnë mallra false apo që kanë hyrë kontrabandë. Ledjon Ilollari thotë se produktet e falsifikuara, e sidomos pijet në shumë raste shkaktojnë pasoja të rënda në shëndet. Për Autoritetin e Ushqimit dhe Drejtorinë e Doganave e vetmja mënyrë për të blerë produkte të sigurta është shoqërimi i tyre me kupon tatimor. "Nuk mund të themi se situata është rozë, problematika ka. Mallra kontrabandë gjithmonë janë futur. Nga të dhënat që ne disponojnë mësohet se nuk janë në një shkallë të lartë, por ekzistojnë. Nuk ka asnjë lloj përgjegjësie nga subjekti që i prodhon apo që i hedh në treg këto produkte. Kemi të bëjmë me një prob-




Foto ilustruese

lem që cenon rëndë shëndetin e konsumatorit" - thotë Ilollari. Gjatë sezonit të verës qarkullimi i shitëseve ambulante dhe

helmimi nga pijet e falsifikuara është në rritje. Autoritetet bëjnë thirrje që qytetarët të denoncojnë çdo rast.

## DOGANAT

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u bën thirrje qytetarëve shqiptarë të tregojnë kujdes ndaj

tregimit të paligjshëm të produkteve të akcizës, veçanërisht alkoolit dhe duhanit. Blerja e këtyre produkteve pa pullën fiskale, shkakton dëm të drejtpërdrejtë në të ardhurat e buxhetit të shtetit, në ekonominë e vendit dhe është një rrezik potencial ndaj shëndetit të qytetarëve. "Gjatë sezonit turistik, Administrata Doganore i kushton vëmendje të veçantë produkteve, të cilat tregtohen në pikat e vogla, të mesme dhe të mëdha të shitjes në të gjithë vendin. Qëllimi këtij sensibilizimi është parandalimi i dëmit që i shkaktohet konsumatorëve vendas dhe të huaj, ekonomisë dhe bizneseve të ligjshme nga këto produkte. Pikat e shitjes dhe konsumatorët në Shqipëri janë të rrezikuar nga kundërvajtës që

tregtojnë pije alkoolike dhe produkte duhanit të paligjshme (pa pullë fiskale), madje edhe të falsifikuara. Produktet e pakontrolluara dhe të pamiratuara për tregtim përbëjnë rrezik serioz për shëndetin e konsumatorëve duke nisur nga origjina e tyre e panjohur, si dhe kushtet e prodhimit dhe të magazinimit jashtë standardeve të pranueshme" - thuhet në njoftimin e doganave. Gjatë kontrolleve të vazhdueshme Administrata Doganore ka identifikuar shumë raste të tregimit të paligjshëm të produkteve të duhanit dhe alkoolit dhe ka vepruar duke konfiskuar mallrat e dyshuar, si dhe duke penalizuar shtetisë. "Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u bën thirrje tregtarëve të mbrojnë biznesin e tyre nga mashtrimi, duke u siguruar mbi besueshmërinë dhe ligjshmërinë e furnitorëve dhe furnizimeve të tyre. Një verifikim i kujdesshëm i jep mundësinë biznesit të ndershëm të kontribuojë në mbylljen e shtigjeve të përdorura nga rrjetet e organizuara të mashtrimit. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është e angazhuar të ofrojë standardet më të larta të shërbimit për konsumatorët dhe bizneset" - përfundon njoftimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUCIONI I KOMISIONERIT PUBLIK

## NJOFTIM

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Institucionit të Komisionerëve Publikë", rishpall vendet vakante për pozicionet:

### Përkthyes (paga II-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Të zotërojë diplomë të nivelit Master shkencor në gjuhë të huaja, dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimumin 5 vjetë eksperiencë në përkthim shqip-anglisht-shqip.
- b) Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët.
- c) Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

Preferohen kandidaturat e licencuara përkthyes zyrtar nga Ministria e Drejtësisë.

### Specialist Protokoll/Arkiv (IV-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Të zotërojë diplomë të nivelit Master shkencor.
- b) Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c) Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

### KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie, sipas Vendimit të Këshillit Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës dorazi nga aplikanti nga data 23 deri 27 korrik 2018, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 4, Tiranë, nga e hëna në të premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 4, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 27.7.2018 dhe të vërtetohet me fletëmandatin e lëshuar nga zyra postare.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon të mbyllura në zarf: 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jeshëkrimin profesional përshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit (letërrisje, pasaportë, kartë identiteti).
- Dokumentet (diplomë, librezë pune, vërtetime, dëshmi, vetëdeklarim, certifikata, trajnime etj.) fotokopje ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislationit në fuqi.
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal (vërtetim nga Gjykata, vërtetim nga Prokuroria, dëshmi e gjendjes gjyqësore).
- Vërtetim nga institucioni ku punon që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Një rekomandim nga punëdhënësi.
- Raport që vërteton se është në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme.

Kandidatët që plotësojnë kriteret formale dhe kanë depozituar dokumente të fotokopjuara, përpara intervistës i parashtrorët Komitetit ad-hoc dokumentet e njësura ose ato origjinale.

## Huaja e BERZH për rrugët

# FSHZH: 140 aplikime nga bashkitë, si përzgjidhen fituesit

Pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit janë regjistruar 140 aplikime për financimin e rindërtimit të segmenteve rrugore, përmes një kredie të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, me një vlerë totale prej 50 mln dollarësh. Marrëveshja e huas aktualisht po diskutohet në komisionet parlamentare, ndërkohë që pas fazës së aplikimeve, që tashmë ka përfunduar pritet nisja e fazës së dytë që ka të bëjë me listimin e aplikimeve mbi bazën e një sistemi kriteresh dhe pikëzimit. Sipas menaxherit të projektit, Ermir Omari rrugët do të përzgjidhen mbi bazën e disa kriterëve kryesorë, që kanë të bëjnë me turizmin, agrikulturën, trafikun apo numrin e popullsisë. "I është bërë thirrje 61 njësisve vendore të qeverisjes për të sjellë segmentet e tyre prioritarë, domethënë që paraqesin bashkitë për investim. Është marrë një listë me rreth 140 rrugë dhe këto kanë rënë në njësitë, të cilat kanë



Foto ilustruese

pasur si kriter turizmin, agrikulturën, numrin e popullsisë dhe trafikun në zonë", tha Omari. Fondi Shqiptar i Zhvillimit bëri me dije për TV SCAN se aktualisht ende nuk ka përfunduar procesi i rankimit, por ajo që vihet re është se një pjesë e mirë e projekteve për të cilat bashkitë kanë aplikuar përfshihen në programet e qeverisë për zhvil-

limin rural dhe programin '100 fshatrat'. Në total janë 55-60 km rrugë që do të financohen nga kjo hua dhe përfitim i logaritit është rreth 8000 banorë. Me t'u bërë efektive marrëveshja do të fillojë puna në terren për zbatimin e investimeve, ndërkohë që periudha më e afërt është tetor - nëntor 2018.

Vjehri i 38-vjeçarit: I terrorizuan familjen, ai s'ka bukë të hajë

# Policia dhe RENEA, "luftë" në Radhimë me të kërkuarin për vjedhje banke

*Gaqo Gjini tentoi të godasë policin me thikë, efektivi e plagos me armë në këmbë*

VLORE

Një aksion i policisë së Vlorës dhe i forcave speciale për kapjen e një të kërkuarin për grabitje banke ka shkaktuar panik tek banorët, pushuesit dhe turistët në Radhimë. Mësohet se blutë dhe RENEA kanë rrethuar banesën (e kishte marrë me qira) ku ndodhej 38-vjeçari Gaqo Gjini dhe i kanë bërë thirrje që të dorëzohet, por ai ka rezistuar. Gjini ka dalë nga banesa me thikë në dorë dhe ka tentuar të godasë një prej punonjësve të policisë. Ndërkohë, ky i fundit për vetëmbrojtje e ka qëlluar me armë në këmbë agresorin për ta neutralizuar. Ngjarja ka ndodhur pasditen e djeshme rreth orës 16:30. Ndërkohë, i plagosuri Gaqo Gjini u dërgua në spitalin rajonal të Vlorës, ku sipas mjekëve ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Pas ngjarjes ka reaguuar vjehri i 38-vjeçarit, i cili hedh poshtë të gjitha akuzat ndaj dhëndrit dhe akuzon policinë se ka bërë terror.

## POLICIA

"Sot (dje) në Radhimë, shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë, të mbështetura nga forcat speciale RENEA, në zbatim të një plani masash për kapjen e një personi në kërkim ishin duke kryer operacion në banesën e shtetasit të shpallur në kërkim G.Gj., 38 vjeç. I kërkuari ka rezistuar duke tentuar të godasë me mjete prerëse një prej punonjësve të policisë. Efektivi në kushtet e vetëmbrojtjes e ka neutralizuar duke e goditur me armë një herë në këmbë. Shtetasi G.Gj. është transportuar për të marrë ndihmë mjekësore në Spitalin Rajonal Vlorë dhe është jashtë rrezikut për jetën", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë së Vlorës. Sipas bluve, 38-vjeçari ishte shtetas i shpallur në kërkim për veprat penale "Plagosje e rëndë me dashje", "Kundërshtim i punonjësve të policisë" dhe "Armëmbajtje pa leje". Po të njëjtat burime thanë se vijon puna nën mbikëqyrjen e Prokurorisë Vlorë dhe SHÇBA-ve për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes. Policia e Shtetit në kuadër të masave për rritjen e parametrevë të sigurisë gjatë sezonit turistik po ushtron kontrolle të shumta në të gjitha zonat me risk për evidentimin dhe kapjen e personave me precedentë që janë aktualisht në territorin e vendit apo që mund të vijnë gjatë verës nga radhët e emigrantëve. Këto kontrolle janë shtrirë dhe po vijojnë me forca e shërbime shtesë të policisë kriminale dhe agjentë civilë, për të garantuar një ambient të qetë dhe të sigurt në qytetet si Durrësi, Fieri, Vlo- ra, Lezha e Shkodra".

## AKUZAT

Sipas burimeve zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Vlorës, 38-vjeçari Gaqo Gjini ishte shpallur në kërkim për veprat penale "Plagosje e rëndë me dashje", "Kundërshtim i punonjësve të policisë" dhe "Armëmbajtje pa leje". Mësohet se Gjini ishte akuzuar edhe për vjedhjen e një banke në vitin 2016. Ndërkohë, që vjehri i tij pohoi se akuzat për grabitjen e bankës është rrëzuar.



Vjehri i Gaqo Gjinit duke folur për "GSH"



## REAGIMI I VJEHRIT

Menjëherë pas ngjarjes ku mbeti i plagosur Gaqo Gjini, baba i dy fëmijë ka reaguuar vjehri i tij. Në një lidhje direkte për "News 24" vjehri i të arrestuarit, (person me precedentë penalë për një grabitje të një banke në 2016-ën, për plagosje të një personi në Vlorë, si dhe për armëmbajtje pa leje) tha se dhëndri i tij nuk kishte lidhje me krimin. Ai pohoi se 38-vjeçari Gjini gjente punë ku të mundej, ndërsa nuk kishte me se të ushqente fëmijët. Po ashtu, vjehri i Gjinit nuk i kurseu akuzat për ish-drejtorin e Policisë së Vlorë, Jaeld Cela, (i shpallur në kërkim si bashkëpunëtor në trafikun ndërkombëtar të drogës me bandën e Habila-

jve), ndërsa shtoi se gjatë kohës së tij, dhëndri u shpall në kërkim. "Ai s'ka bukë për darkë. Ne s'dimë gjë fare, tani erdhëm. Tani e morëm vesh nga vajza që aty kishin hyrë 500 policë në shtëpi. E shpallën në kërkim kur ishte ai shefi i degës, i pari, ai i degjeneruari që është shpallur në kërkim. Akuzat për grabitjen e një banke janë rrëzuar. Po të kishte grabitur, ai do të kishte gradaçela. Vajzën e gjetëm pa ndenja, me dy fëmijë të mitur. Ai s'ka grabitur asgjë, le të thonë ca të duan. Dhëndri ka rreth 6 të duan e ca në këtë banesë. Në atë banesë jeton vajza me dhëndrin. Ku ka gjetur punë, ka punuar, ku të gjente punonte", - tha vjehri i Gaqo Gjinit.

Policia e Shtetit në kuadër të masave për rritjen e parametrevë të sigurisë gjatë sezonit turistik po ushtron kontrolle të shumta në të gjitha zonat me risk për evidentimin dhe kapjen e personave me precedentë që janë aktualisht në territorin e vendit apo që mund të vijnë gjatë verës nga radhët e emigrantëve.

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

## UET BURSAT

# UET shpall politikën e re të bursave, kuotat dhe buxhetin

*750 mijë euro për 500 bursa të plota dhe gjysmëbursa për një vit akademik*

Universitetit Europian i Tiranës, që nga themelimi i tij, e ka kthyer sistemin e bursave në një traditë shumë të rëndësishme. Ky sistem ka në vetvete një shumëllojshmëri përfituesish nga të gjitha shtresat sociale, të gjitha profilet e jetës publike dhe e vë theksin në promovimin e ekselencës. Qëllimi i këtyre bursave është pikërisht integrimi dhe dhënia e mundësive për studim të gjithë individëve.

Universiteti Europian i Tiranës ka prezantuar politikën e re të bursave. UET duke filluar nga viti i ri akademik do të japë në total 500 bursa për studentë të kategorive të ndryshme. Një numër i madh bursash, për të cilat buxheti kap një vlerë prej 750 mijë eurosh.

Bursat janë të kategorive të ndryshme që UET ka ofruar ndër vite, të tilla si bursa të plota ekscelence, gjysmëbursa, bursa talenti, bursa sociale, bursa leadershipi, bursa "Pashko".

Ndërkohë që Universiteti Europian i Tiranës bëhet universiteti i parë privat, i cili do të hapë të gjithë gamën e degëve të shkencave humane dhe sociale, edhe pse shpesh ato janë të vështira në treg për t'u financuar nga përdoruesit. Për këtë qëllim, ky kontingjent bursash i është dedikuar promovimit të këtyre degëve me anë të bursave apo gjysmëbursave në degë të tilla si: filozofia, antropologjia, sociologjia, letërsia, gjuha, artet, historia, studimet religjioze etj., pra të gjitha degët sokratike.

Administratori i Universitetit



European të Tiranës, Arbi Agalliu është shprehur se politika e bursave të UET është një iniciative e madhe që UET ndërmerret në kuadrin e promovimit të të

rinjve, të cilët janë të talentuar në fusha të ndryshme, ekselentë në studime ose në pamundësi ekonomike për të vijuar arsimimin e tyre.

"Politika e bursave na bën të ndjehemi krenarë, që Universiteti Europian i Tiranës nuk e ka vëmendjen vetëm mbi aktivitetin akademik, por mundohet të

marrë përsipër një përgjegjësi sociale, që e parë personalisht duket shumë pak, por e parë në pozicionin e institucionit është shumë, mjafton të përmendim buxhetin e parashikuar për këtë iniciativë, që është përafërsisht 750 mijë euro. Kjo është një shumë e madhe parash, e cila shkon me dëshirën më të madhe për të përkrahur më të talentuarit dhe për të bërë një hop cilësor drejt dijes. Duke i dhënë mundësi edhe atij që është në pamundësi financiare dhe për të përkrahur këdo që ka një talent të caktuar dhe ka një dëshirë për të bërë mirë në këtë shoqëri, ku çdo ditë e më tepër ka nevojë për njerëz, të cilët marrin përsipër përgjegjësi sociale".

Kusht bazë për përfitim dhe ruajtjen këtyre bursave është aktivizimi studentor, pjesëmarrja në debate, grupe kërkimore etj., ruajtja e një niveli të caktuar të mesatares sipas degës dhe sipas momentit të hyrjes në sistemin akademik, si dhe kontributi në shërbim të komunitetit të studentëve dhe të institucionit në raport me mënyrën se si studentët marrin pjesë në qeverisjen dhe menaxhimin e institucionit.

Presidenti i Universitetit Europian të Tiranës, Ardian Civici, është shprehur se në Universitetin Europian të Tiranës, bursat kanë një rëndësi të veçantë për shkak të filozofisë që përfaqësojnë. "Ti japësh dikujt një bursë, përveçse pjesës së përgjegjësisë sociale të institucionit, do të thotë që të gjithë shoqërisë shqiptare t'i krijosh një mundësi më shumë për një të ri më të përgatitur; më të ditur, i cili pastaj do t'ia shpërblejë disafish shoqërisë këtë gjë. Nëse ne e realizojmë misionin, që studentëve tanë t'u japim këtë armë kaq të fuqishme, siç është dija, njohuritë dhe i gjithë zhvillimi të mbështetur mbi këtë bazë, sigurisht që do jemi një shoqëri shumë më demokratike, shumë më e zhvilluar dhe që do të ecë përpara shumë më shpejt".

UET i jep prioritet shpërndarjes së bursave në të dyja llojet e saj, edhe ato sociale të cilat kanë për qëllim të kontribuojnë në përfitim e një arsimimi, edhe për ata individë të cilët vijnë nga shtresa apo kategori të pafavorizuara në aspektin social dhe ekonomik, por njëkohësisht të promovojë të gjithë ata individë, të cilët kanë një talent apo japin një kontribut të caktuar për shoqërinë, ose shfaqin arritje të larta akademike.

"Besoj që gjatë këtyre viteve

## PRESIDENTI I UET: MISIONI I UET, T'U JAPIM STUDENTËVE DIJEN SI ARMËN MË TË FUQISHME



kemi gjetur një ekuilibër midis promovimit të të dyja kategorive të bursave, edhe për të pasur përmasën e asaj që quhet përgjegjësi sociale, por njëkohësisht edhe për përmasën

tjetër ku për dijen dhe për talentin nuk duhet të ketë asnjë kufizim në hapësirat e tij, për t'u zhvilluar, për t'u shkolluar dhe për t'u bërë sa më i ditur".

## Vëllezërit kampionë, fitues të bursës së talentit në UET



Erison Ramaj është student në Universitetin Europian të Tiranës, për degë Komunikim Dizajn dhe sapo ka përfunduar vitin e tij të parë të studimeve. Ai ka përfutur Bursën e Talentit në UET, për shkak se është 12 herë kampion i Shqipërisë në xhudo. "Unë kam rreth 7 vite që merrem me sportin e xhudos. Kam marrë pjesë në një numër të madh kampionatesh, brenda e jashtë vendit dhe jam shpallur 12 herë kampion i Shqipërisë. Në UET aplikova për shkak të cilësisë që ka si institucion arsimor dhe përfitim i bursës së talentit ishte për mua një mundësi e shkëlqyer", shprehet ai. Edhe Arindin, vëllai i Erisonit është gjithashtu student në UET për degën Shkenca Politike, edhe ai përfitues i bursës së talentit, për shkak të angazhimit të tij tejet të suksesshëm në fushën e futbollit. Mamaja e dy vëllezërve të talentuar, Valbona Ramaj, e pranishme në këtë organizim, shprehet se fakti që fëmijët e saj janë të dy fitues të bursës së talentit është një kënaqësi e veçantë për të.

"Si prind, kam pasur një kënaqësi të jashtëzakonshme, një 'medalje', që dy djemtë e mi janë bërë pjesë e UET si fitues të bursës së talentit".

SI TË ZGJIDHNI PROBLEMIN ME DIARRENË NËPËRMJET ILAÇEVE NATYRALE

# SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E premtë 20 Korrik 2018

audiapepa



BALERINA SHQIPTARE

**Klaudia Pepa i habiti të gjithë, ja çfarë ka bërë balerina**



**Françeska 'godet' përsëri fansat**

**BULEVARDI POLITIK**



- Taulant Balla i shkel syrin presidentes kroate, deputeti i PD: Derrkuci në rolin e 'playboy'-it
- Rama pi kafe në Kuvend pas krahëve të Presidentes së Kroacisë
- Robert Bitri i LSI-së kalon në radhët e deputetëve të PS
- Deputetja Reme Lala, me dhimbje koke në Kuvend



Rrëfëhet artisti: Muzikën e bëj se më teket, nuk është pasion universal

## KASTRO ZIZO:

### Kam shumë pengje në jetë dhe pak lumturi

*"Këshilla për të rinjtë: Përdorni prezervativ"*

Rrëfëhet artisti: Muzikën e bëj se më teket, nuk është pasion universal

# Kastro Zizo:

## Kam shumë pengje në jetë dhe pak lumturi

*"Këshilla për të rinjtë: Përdorni prezervativ"*

Egla Xhemali

**K**astro Zizo është një nga personazhet më solar të ekranit shqiptar. Të gjithë e njohim për shpirtin e lirë dhe sinqeritetin në përgjigje kur ka dalje në emisione të ndryshme. Kjo verë e ka gjetur me mjaft impenjime. Në një rrëfim për suplementin "Summer Pages" të "Gazeta Shqiptare", ai na njeht me pjesën përtej ekranit. Kastro na pohon se është një baba konservator, por që mundohet ta bëjë më së miri rolin e prindit. Burimi i energjisë së tij janë njerëzit dhe gjërat në përgjithësi, qofshin këto edhe të këqija. I pyetur për shoqërinë ai pohon se ka shumë miq e pak shokë. Jeta sipas tij është një cikël pendesash dhe ndonjëherë pak lumturi. Sa i përket muzikës ajo për të nuk është një pasion universal. Kastro na thotë se është fokusuar më shumë në media dhe në atë se çfarë do nisë në sezonin e ri televiziv.

**Si ka nisur vera për Kastron?**



Me shumë punë, bile rrallë e kuptoj që ka ardhur vera.

**Ku do i kaloni pushimet?**

Pushimet besoj do të jenë nga shqiptari dhe ende se kam vendosur se ku, mbase mal.

**Çfarë e rrëmben kohën tuaj?**

Cikli i dokumentareve që po bëj mbi qytetet në Shqipëri.

**Si është Kastro në rolin e babit?**

Një baba relativisht konservator, që mundohet ta bëjë këtë rol sa më mirë.

**Cili është sporti juaj i preferuar?**

Nuk jam shumë i sportiveve, ndoshta golfi në det!(qesh)

**Jeni një nga personazhet më solar që ka media në Shqipëri. Nga buron gjithë ajo energji?**

Nga një përzierje hithrash dhe tu-

tkalli, që e marrë çdo mëngjes. Unë marrë energji nga çdo gjë qoftë dhe nga njerëzit apo gjërat e këqija.

**Në çdo dalje tuajën bien në sy sinqeriteti kur përgjigjeni dhe të qenit i lirë. A mos është pak e rrezikshme?**

Rrezikun tashmë e kam ngrënë me bukë e fasule është tepër vonë për t'u tërhequr.

**Si janë raportet tuaja me kolegët? Shumë të mira, kryesisht me ata që janë të çiltër e sinqertë si unë.**

**Kastro ka shumë miq apo është selektiv?**

Kam shumë miq e pak shokë.

**A keni ndonjë peng?**

Shumë pengje, por kjo është jeta një cikël me pengje, pendera dhe ndonjëherë pak lumturi.

**Një nga pasionet tuaja më të mëdha është muzika. Keni menduar ndonjëherë të hiqni dorë nga ajo?**

Besoj se jo, por, nëse do ndodhë le të ndodhë. Unë muzikën e bëj se me tekut ta bëj dhe jo se është ndonjë pasion universal.

**Aktualisht, a keni ndonjë projekt në duar? Nëse po kur do vij për publikun?**

Kam tre materiale muzikore, që se di a do t'i nxjerr shpejt apo në vjeshtë. Jam fokusuar më shumë në media dhe në atë se çfarë do nis në sezonin e ri televiziv.

**Me çfarë motoje ka ecur Kastro në jetë?**

Bëj të tjerët të lumtur dhe ndoshta do kesh ndonjë buzëqeshje!

**Çfarë mesazhi do i jepni sot të rinjve?**

Përdorni prezervativ!



## Eni Koçi, më tërheqëse se kurrë

Ajo është një nga këngëtareset më të pëlqyera të momentit. Kohët e fundit bukuroshja ka qenë mjaft aktive në rrjetet sociale, ku ka ndarë me fansat e saj foto nga këto ditë të nxehta. Këtë herë Eni ka publikuar një foto mjaft verore në rrjetin social "Instagram", ku e shohim më në formë se kurrë. E veshur tërë ngjyra Eni dukej mjaft tërheqëse.




## Françeska 'godet' përsëri fansat


Modelja Françeska Jaçe duket më në formë se kurrë këtë verë. Bukuroshja duket se po i shijon pafund këto ditë të nxehta. Jaçe së fundmi ka publikuar në rrjetin social 'Instagram' një foto nga plazhi ku shfaqet tejet provokuese me bikini. Françeska shquhet për foto mjaft tërheqëse dhe provokuese, që i lenë fansat pa fjalë. Si gjithmonë modelja ka pasur komente pozitive nga ndjekësit e saj.



## Klaudia Pepa i habiti të gjithë, ja çfarë ka bërë balerina

Balerina e njohur Klaudia Pepa vijon të na habitë me pozat e saj në rrjetet sociale ditëve të fundit. Mesa duket nuk ka ndërmend të ndalet. Këtë herë bukuroshja ka postuar një foto në rrjetin social "Instagram", ku e shohim në det duke bërë një ushtrim mjaft të vështirë, sparkatën në mënyrë horizontale. Ajo që bie në sy natyrisht është trupi perfekt i Klaudias veshur me rroba banje të zeza. Balerina po i shijon në maksimum këto pushime.




 klaudiapepa



## Zhvizhet Tayna, reperja nxjerr gjoksin bombastik

Tayna është kthyer tashmë në emrin më të komentuar në rrjet, që pas bujës që bëri me dy këngët "Columbiana" dhe "Shqipe", të cilat i dhanë menjëherë famë. Po ashtu edhe fakti që reperet janë të rralla në tregun muzikor shqiptar, kjo e bëri Taynën të fitonte edhe më shumë vëmendje. Mirëpo reperja nuk është vetëm e talentuar në rep, por edhe një femër shumë seksi. Këtë e vërteton edhe foto e saj e fundit në 'Instagram', ku Tayna shfaqet vetëm me reçepte tekta tregon gjoksin bombastik. "Se kurgjo që vesh s'o ma e ransishme se buzëqeshja", shkruan Tayna dhe menjëherë kanë nisur komentet për këtë look të saj ku shumica sigurisht janë përqendruar së komentuari dekoltenë e reperes.



Purtha apo diarreja është gjendje kur kemi jashtëqitje të shpeshta, pothuajse në tërësi në gjendje uji dhe kur sasia ditore është mbi 300 gramë.

**M**ë së shpeshti fjala është për diarrenë akute, e cila shfaqet te personat paraprakisht krejt të shëndetshëm. Diarreja akute zakonisht është pasojë e infeksioneve të organeve të tretjes, e cila shfaqet nën ndikimin e baktereve të ndryshme, viruseve, kërpudhave dhe parazitëve. Ky lloj infeksioni shpesh mund të zgjasë prej disa orësh deri në disa ditë. Diarreja është një sinjal i dhënë nga trupi, i cili përpqet të shpëtojë sistemin nga një lëndë e rrezikshme.

**Çfarë mund të bëjmë për ta ndaluar sa më shpejt diarrenë?**

Përpqini të qëndroni larg kurimit të diarresë me anë të ilaçeve të marra pa recetë dhe mundohuni të përgatisni zgjidhje natyrale për ndalimin e saj, thuhet në një lajm të botuar në revistën "Reader's Digest".

**Lëngu i mishit të pulës ose lëng frutash**

Lëngu i mollës apo ai i mishit të pulës do të zëvendësojnë mineralet dhe kripërat e humbura nga diarreja. Qëndroni larg lëngut të portokallit, ananasit, domates dhe frutave apo zarzavateve të tjera, sepse acidet e tyre do të dëmtojnë zorrët e infektuara nga virusi. Pini pak nga pak nga lëngjet e këshilluara pak më sipër dhe përsëriteni këtë veprim çdo gjysmë ore.

**Përdorni orizin**

Orizi i bardhë i hap rrugë kapsllëkut. Konsumojeni pak nga pak orizin e bardhë të gatuar pa yndyrë derisa t'ju kalojë diarreja.

**Qetësohuni me çajin e kamomilit**

Me anë të veçorisë së tij relaksuese, çaji i kamomilit mund të lehtësojë diarrenë. Krahas kësaj, do të lehtësojë edhe dhimbjet e barkut të shkaktuar nga diarreja.

**Mjalti**

Janë të shumëta ata popuj, të cilët e kanë përdorur mjaltin në kurimin e diarresë. Hidhni 4 lugë mjaltë në një gotë me ujë të nxehtë dhe pijeni pasi të ftohet pak. Mjalti është efektiv në kurimin e diarresë.

**Pini ujë me uthull**

Nëse diarreja është shkaktuar



# Si të zgjidhni problemin me diarrenë nëpërmjet ilaçeve natyrale



nga një infektion bakterial, uthulla e mollës mund të jetë një zgjidhje e mirë për ta ndaluar atë, sepse përmban veçorinë antibiotike. Pektina e gjendur tek uthulla e mollës ndihmon në lehtësimin e spazmave të zorrëve.

**Pure me mollë**

Pureja e mollës përmban pektinë, e cila ndihmon në rregullimin e lëvizjeve të zorrëve. Nëse konsumoni një fetë buke

të thekur të lyer me pure molle, nuk do t'ju përzihet as stomaku.

**Praktikoni dietën 'Brat'**

Kjo është një dietë e sigurt kundër diarresë, sepse përmban banane, oriz, pure molle, bukë të thekur dhe çaj. Në të njëjtën kohë do t'ju mbajë të ngopur.

**Pini një gotë dhallë**

Edhe dhalli është një lëng që ndikon pozitivisht në ndërpre-

rjen e diarresë. Sipas indi-anëve, personat me diarre duhet të konsumojnë nga një gotë dhallë me zenxhefil të tharë 3-4 herë në ditë.

Provoni çajin e zi Lënda Tanin e gjendur tek çaji i zi vepron mbi shtresat mukus të zorrëve. Kjo ndihmon në thithjen e lëngjeve nga trupi dhe në lehtësimin e infeksionit të zorrëve. Krahas kësaj, edhe boronicat apo thanat ndi-

hmojnë në lehtësimin e diarresë.

**Përgatisni çaj me lëkurë portokalli të freskët**

Lëkura e portokallit ve në lëvizje sistemin tretës. Hiqni lëkurën e një portokalli dhe ndajeni në copa të vogla. Vendosini pjesët në një xheze apo çajnik dhe hidhni sipër ujë të valuar. Prisni derisa të ftohet pak. Kullojeni dhe pijeni në ëmbëlsuar me mjaltë.



## Taulant Balla i shkel syrin presidentes kroate, deputeti i PD: Derrkuci në rolin e 'playboy'- it

Gjatë vizitës së saj në Tiranë, Presidentja e Kroacisë ka mbajtur një fjalim në Kuvendin e Shqipërisë.

Kolinda Grabar Kitaroviç tha se shqiptarët sakrifkuan jetën për lirinë e Kroacisë. Ajo tha se shqiptarët që jetojnë në Kroaci janë të respektuar dhe të integruar.



Më vonë zëdhënësja e Partisë Demokratike Silvi Bardhi ka nxjerrë një video ku shfaqet kreu i grupit parlamentar Taulant Balla që i shkel syrin presidentes kroate Kolinda Grabar Kitaroviç. Këtë e ka komentuar edhe deputeti i PD, Edi Paloka, i cili ka ironizuar kreun e grupit të PS. "Tao Derrkuc Palla në rolin e play boy-t me Presidenten e Kroacisë... Do e ketë ngatërruar me ndonjë kroate tjetër ...," shkruan Paloka.

## Rama pi kafe në Kuvend pas krahëve të Presidentes së Kroacisë

Presidentja e Kroacisë Kolinda Grabar Kitaroviç ka shkuar shumë herët në Kuvend, dje, për të mbajtur fjalën përsëritëse, me rastin e vizitës së saj. Ndaj edhe kryeministri Rama duket se ka qenë "i etur" për të pirë një kafe, para se të fillonte fjalimi i Presidentes. Ai është kapur në një foto, që pas krahëve të Kitaroviç pi kafën, ndërsa kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi po lexon përsëritësen për miken kroate. Një veprim i tillë nuk përbën asnjë gabim, por nga kundërshtarët politikë kjo është interpretuar si mungesë respekti.



# BULEVARDI

Në merrni seriozisht! 😊

# POLITIK



## Robert Bitri i LSI-së kalon në radhët e deputetëve të PS

Ish-deputeti i LSI-së, Robert Bitri më në fund i është bashkuar rreshtit të deputetëve të PS-së, në sallën e seancave plenare.

Ai është kapur nga fotografi Agim Rama, duke u përshëndetur me deputetët socialistë dhe i ulur në krah të Bashkim Finos. Në fakt, pak ditë më parë kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi nuk e dinte se Bitri



ishite larguar nga grupi i tyre, por tashmë duket se kjo është bërë fakt, edhe pas votimit të disa ligjeve sipas vendimit politik të PS-së.

## Deputetja Reme Lala, me dhimbje koke në Kuvend

Është fjala për 22 vjeçare Reme Lala, e cila është kapur nga kamerat duke masazhuar kokën si për të lehtësuar dhimbjen. Duket se Reme Lala është detyruar dje të shkojë në seancë për shkak edhe të pranisë së presidentes kroate. Deputetja e PDIU që së fundmi i është bashkuar Edi Ramës është e vetmja nga opozita që po vazhdon të qëndrojë në sallë ndërsa të gjithë deputetët e opozitës janë larguar pasi kërkuar rivotim për Teatrin, meqë kjo gjë nuk u mor parasysh, në shenjë proteste, braktisën sallën.



## DEBATI

# KIÇO LONDO:

## Nuk kam shkresë zyrtare nga ministria për zhvendosje, cili është fati i TKE?

Fatmira Nikolli

Në mbyllje të sezonit artistik 2017-2018 drejtori i Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli", Kiço Londo ka dalë në një konferencë për shtyp. Vetë godinës i rrezikohet e ardhmja, ndërsa një ligj që parashikon shembjen e saj dhe teatrit përbri, u miratua në parlament me 5 korrik. Por, ndërsa protesta vazhdon sikundër këmbëngulja e qeverisë për të rrafshuar dy teatro me qëllim ndërtimin e një të riu me formulën e partneritetit publik privat, Londo, del të flasë për sezonin e ardhshëm. Paçka dheut që rrëshqet nën këmbë, ai ulet para mediave nën ambiguitetin e së ardhmes kërcënuese, shpresës për një kthesë të papritur dhe dëshirë për një imazh naiviteti mbi çfarë ndodh prej shkurrit në Tiranën kaotike.

"Nuk kam asnjë shkresë zyrtare nga Ministria e Kulturës për zhvendosje tek 'Arturbina'. Ka nisur puna për hartimin e kalendarit të ri artistik duke pasur parasysh tri sallat e Teatrit Kombëtar eksperimental, që menaxhoj", tha ai dje, pavarësisht këmbënguljes së gazetarëve që e shtruan pyetjen në mënyra të ndryshme.

### KONFERENCA

Në krye të herës, Londo, tha se "dua të ndaj me ju dy gëzime, më duhet që fillimisht t'u prezantoj që ftesës sonë për të qenë të pranishëm në sezonin e ardhshëm i janë përgjigjur aktori shqiptar Enver Petrovci, Luiza Xhuvani, Luftar Paja. Nuk është fort kohë përshatshme megjithatë na duhet ta bënim këtë gjë. Ka qenë stinë teatore e ngjeshur me 16 premiera, me 410 shfaqje, është një rezultat jo fort i zakonshëm". Kujtoi se para katër muajsh ka themeluar Institutin e Teatrit Kombëtar Eksperimental 'Kujtim Spahivogli' që u inauguroi me botimin e "Sistemit" e Stanislavskit përkthyer nga Mehmet Xhelili. Dje, zbuloi botimin e dytë të institutit, që është libri i regjisorës Stella Adler nën titullin "Arti i aktorit", emër i madh i teatrit botëror që ka sjellë aktorë si Brandon apo De Niro. "Libri është përkthyer nga aktorka e TKE Adriana Tolka, që ka punuar në mënyrë vullnetare. Ka



Kiço Londo

*"Nuk mund të ketë dy drejtorë 'Turbina', kam pyetur se cili është fati i kësaj godine"*

në kopertinë dy aktorë të TK-së që nuk jetojnë më, Bujar Lako dhe Fatos Sela dhe është redaktuar nga Timo Flloko. Do jenë 10 libra në një kolanë për teatrin. Në këtë moment të rëndësishëm për jetën e teatrit shqiptar në përgjithësi, kjo aktore vjen si një dashuri e respekti i madh për punën e mundimshme të aktorit duke parë atë si aristokrat dhe si luftëtarë", tha Londo, duke vijuar me gjuhën e tij diplomatike nën velin ambig të mesazheve publike që jep, ku ndërthuren punonjësi që varet nga Ministria e Kulturës dhe Kiço-që me gjasë ndahet prej saj kryekëput.

Foli për ardhjen e katër regjisorëve të huaj në sezonin e ardhshëm, për drama nga Shqipëria e nga Kosova, për mbledhjen e bordit në muajin gusht dhe prezantimin e titujve në shtator, për shfaqjet për fëmijë, për 5-6 drama të huaja dhe dy shqipe,

për stile e epoka që përfshijnë antikitetin, Shekspirin dhe ditët tona, deri tek një lbesn i pavënë më herët.

### ZHVENDOSJA SI PIKËPYETJE

Por, sezoni i ardhshëm për të cilin flet Kiço Londo, po hartohet duke pasur parasysh TKEKS që kemi sot, nëse harrojmë që një ligj i miratuar e zhdok atë, pa e përmendur fare, si të mos ishte, siç gjithë personazhet politike i referohen vetëm teatrit përbri në sinkron të plotë.

Duke qenë se ministria Mirela Kumbaro ka deklaruar në media se 'Turbina- skena e re pranë Liqenit do të menaxhohet nga drejtorët e TK-së dhe TKEKS-së, Kiço u pyet dje për zhvendosjen e tij. "Deri tani jemi këtu. Jemi një institucion në varësi të Ministrisë së Kulturës dhe padyshim që eprori mund të japë urdhra e të veprojë, por deri tani jemi këtu. Në varësi të situatës së mëtejshme do të ndër-

tojmë edhe në punën tonë". Shtoi se "ka një situata farë pranë teatrit, domethënë në Teatrin Kombëtar Eksperimental, që njihet. Ajo ndikon tek ne, por ne jemi munduar që të vazhdojmë punën se nuk mundet ta nisim punën në tetor se nuk mundet të djegim stinën teatore 2018-2019. Janë 410 shfaqje, është gjysma e shfaqjeve të 11 teatrove".

I pyetur direkt për zhvendosjen tha se "ne kemi biseda të përditshme me Ministrinë e Kulturës, por nuk kemi një vendim zyrtar. Bisedat janë, biseda pune. Urdhër me shkrim për zhvendosje nuk kemi akoma. Ne jemi institucion varësie nën MK dhe ne do të vijojmë të sillemi si institucion varësie. Unë kam paraqitur para ministrisë ambientet që ne kemi në dispozicion, me të cilat kemi këtë rezultat. Vendosja në një ambient tjetër,



Vendosja në një ambient tjetër është detyrë e tjetërkujt. Ia kam kërkuar kryetarit të bashkisë publikisht, në bisedën që bëri me artistët dhe që mori përsipër ta zgjidhte zhvendosjen e teatrit, dhe i kam thënë: Ku është Teatri Kombëtar Eksperimental 'Kujtim Spahivogli'?



Protesta e artistëve në mbrojtje të teatrit

është detyrë e tjetërkujt. Ia kam kërkuar kryetarit të bashkisë publikisht, në bisedën që bëri me artistët dhe që mori përsipër ta zgjidhte zhvendosjen e teatrit, dhe i kam thënë: ku është Teatri Kombëtar Eksperimental 'Kujtim Spahivogli'?. Është një teater me 410 shfaqje në vit. Numri i spektatorëve në teatër është i barabartë 10% të popullsisë së kryeqytetit. Ne kemi për detyrë të arrijmë këto rezultate. Ne kemi për detyrë të përgatitemi për të ardhmen, siç i shërbejmë në publikut, të tjerë duhet të na shërbejnë ne", -tha ai, duke dalë nga ambiguiteti në një situatë të vetme që e sheh rrezikun në sy.

Kur iu tha se ministria e Kulturës ka deklaruar se menaxhuesit e Turbinës do të jenë drejtuesit e Teatrove Kombëtarë, Londo, tha se "kjo që thoni ju, na fut në një rrugë tjetër, në kushte të tjera. Ne jemi këtu në këtë teatër me 3 salla dhe lirinë e plotë e veprimt. Nëse dikush merr vendim të bëjë diçka tjetër, ata duhet ta kenë menduar. Mua nuk më është lënë të mendoj, as të punoj që të menaxhoj një godinë ku do të jenë 2, 3, 1 apo 4 teatro të tjerë. Nëse kjo do të ndodhë duhet të gjendet një njeri ta organizojë. Jemi teatro me funksione dhe me ritme krejt të kundërta. Jam duke punuar për kalendarin që thashë, ne rrethana e kushte të tjera, natyrisht do më duhet të marr një vendim".

Pas ngulmimit, kur tanimë qetësia që ruante ia la vendin një farë shqetësimi të mbajtur fshehur me zor, Londo tha: "Ju doni të dini ku është teatri im? Teatri që varet nga unë është teatri shëtitës 'Çajupi'. Ky këtu është teatër shtetëror. Ju më thoni që atje do jenë bashkë TKE dhe TK dhe Opera. Ç'lidhje kam unë me ta? Mua nuk më është thënë gjë ende. Nuk i kam parë skenat e Turbinës. Nuk jam pyetur për ngritjen e Turbinës. Dhe nuk kam marrë pjesë në asnjë takim", -përfundoi ai.



**KËRKESA**  
Ne i kërkojmë Qeverisë Shqiptare, Bashkisë Tiranë, Ministrisë së Kulturës, si edhe të gjitha palëve të tjera të përfshira, të rikonsiderojnë vendimin e tyre për të shembur këtë monument evropian dhe të shqyrtojnë mundësinë të ofrojnë, të paktën, rinovimet më bazike, për ta sjellë teatrin aktual në standarde.



# “Europa Nostra”, Ramës: Ruaj Teatrin Kombëtar

Organizata europiane “EUROPA NOSTRA”, zëri i trashëgimisë kulturore në Evropë, përmes një letre, i kërkon kryeministrit të Shqipërisë ruajtjen e Teatrit Kombëtar. Në vijim të reagimit që bëjnë teksta përshkruajnë rëndësinë historike e arkitektonike e kulturore të Teatrit Kombëtar, ata shkruajnë se nuk bien dakord me asnjë qëndrim që e cilëson këtë monument si të pavlerë e të padenjë për vlerën historike që mbart. Përkundrazi vëjnë në “Europa Nostra beson se VLERAT E PAÇMUARA EUROPIANE të kësaj prone publike i tejkalojnë shumfish përfitimet afatshkurtra të atyre që duan ta shembin atë”.

like e rëndësishme për qytetin. Teatri është një shembull i shkëlqyer i arkitekturës moderne italiane nga kjo periudhë kohore dhe është e vetmja ndërtesë e këtij lloji që ekziston në Shqipëri. Është një nga monumentet e fundit historike që kanë mbijetuar në kryeqytet.

Teknika e ndërtimit e përdorur dhe elementet strukturore janë me rëndësi historike unike dhe përfaqësojnë një pikë kulmore në zhvillimin e urbanistikës së Tiranës. Mbrojtja e këtij tipi historik arkitekture është me rëndësi themelore, pasi përfaqëson një pjesë të pazëvendësueshme të trashëgimisë së vendit dhe ruan një vend të veçantë në kujtesën kolektive të së shkuarës së tij.

Në këtë këndvështrim, ne nuk pajtohemi me mendimin se kjo ndërtesë ka pak ose aspak vlerë historike, kulturore apo sociale. Përkundrazi, “Europa Nostra” beson se vlerat e spikatur europiane e kësaj prone publike tejkalojnë çdo përfitim afatshkurter që mund të vijë nga shkatërrimi i saj.

“Europa Nostra” ndan të njëjtin shqetësim, tashmë të shprehur nga ndaj jush nga Ana Tostoes, kryetare e Docomomo International, në letërën e saj drejtuar vendimarrësve të rëndësishëm më 12 prill 2018. “Europa Nostra”, gjithashtu, i bashkohet në solidaritet grupit të respektuar të specialistëve të restaurimit, profesionistëve dhe akademikëve në fushat e shkencës dhe kulturës, si edhe të shumë anëtarëve aktivë të shoqërisë civile që janë shprehur me kaq vendosmëri për të mbrojtur Teatrin Kombëtar nga shembja.

Ndërkohë që e kuptojmë nevojën që ka kryeqyteti shqiptar për një teatër të ri, që plotëson standarde ndërkombëtare, ne nuk mund të mbështesim asnjë propozim që shkatërron teatrin ekzistues.

Ne i kërkojmë Qeverisë Shqiptare, Bashkisë Tiranë, Minis-

**LETRA E PLOTE**

z. Edi Rama  
Kryeministër i Shqipërisë  
Zyra e Kryeministrit  
Bulevardi Dëshmorët e Kombit  
Tiranë

Hagë, 18 korrik 2018

Lënda: Trashëgimia në rrezik – Kërkohet mbështetje  
Teatri Kombëtar i Shqipërisë,  
Tiranë, Shqipëri

I dashur z. Rama  
“Europa Nostra” (Europa Jonë) – Zëri i Trashëgimisë Kulturore në Europë dëshiron t’ju shprehë shqetësimin e sinqertë në lidhje me vendimin alarmues për shembjen e Teatrit Kombëtar të Shqipërisë, një objekt trashëgimie me rëndësi kulturore dhe arkitekturore të madhe për Europën.

Teatri Kombëtar, i ndërtuar më 1938 nga arkitekti italian Giulio Berte’, është një nga qendrat kulturore më të spikatura të Tiranës dhe një hapësirë sociale dhe pub-



Faksimile e letres së “Europa Nostra” dërguar kryeministrit

*Shkresa që i drejtohet kryeministrit: Jemi të shqetësuar për shembjen, mbrojeni*



trisë së Kulturës, si edhe të gjithë palëve të tjera të përfshira, të rikonsiderojnë vendimin e tyre për të shembur këtë monument Evropian dhe të shqyrtojnë mundësinë të ofrojnë, të paktën, rinovimet më bazike, për ta sjellë teatrin aktual

në standarde.  
“Europa Nostra” ka një interes të veçantë për trashëgiminë kulturore të Shqipërisë dhe prej shumë vitesh i ka ndjekur nga afër zhvillimet atje. Në 2013 dhe 2018, respektivisht, amfiteatri romak në

Teknika e ndërtimit e përdorur dhe elementet strukturore janë me rëndësi historike unike dhe përfaqësojnë një pikë kulmore në zhvillimin e urbanistikës së Tiranës. Mbrojtja e këtij tipi historik arkitekture është me rëndësi themelore, pasi përfaqëson një pjesë të pazëvendësueshme të trashëgimisë së vendit dhe ruan një vend të veçantë në kujtesën kolektive të së shkuarës së tij.

Durrës dhe Kishat Post-Bizantine në Voskopojë e Vithkuq, u përfshinë në listën e “Shtatë Objekteve më të Rrezikuara” të trashëgimisë në Europë. Ne’ gjithashtu’ po ndjekim nga afër zhvillimet në qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës, të listuara si Trashëgimi Botërore nga UNESCO.

Pavarësisht rrethanave të vështira, ne kemi rifituar siguri nga zhvillimet pozitive në secilin prej këtyre qendrave, falë gatishmërisë së sinqertë të autoriteteve shqiptare për të hyrë në dialog me të gjithë palët e interesuara, për gjetjen e zgjidhjeve që respektojnë kërkesat e secilit rast.

Me këto në mendje, ne ju bëjmë thirrje të përdorni pozicionin tuaj të nderuar dhe ndikimin pozitiv për të mbrojtur Teatrin Kombëtar të Shqipërisë.

Juaji sinqerisht  
Prof. Dr. Hermann Parzinger  
President Ekzekutiv  
“Europa Nostra”





Presidenti i SHBA-ve: Në Mal të Zi mund të shpërthejë Lufta e Tretë Botërore

# I akuzoi si agresivë, malazezët i përgjigjen Trump: Krenarë për historinë tonë

## "Jemi të parët që i bëmë rezistencë fashizmit"

Qeveria e Malit të Zi i është përgjigjur presidentit amerikan Donald Trump, i cili tha se malazezët janë popull agresiv dhe mund ta shtojnë botën drejt luftës së tretë. Në reagimin e tyre zyrtar malazezët thonë se thonë se shteti i tyre është krenar për historinë dhe traditën si dhe politikën e paqes së ndjekur. Ata shtojnë po ashtu se Mali i Zi është shteti i parë në Evropë që ofroi rezistencë ndaj fashizmit. Reagimi i Malit të Zi vjen i bashkëngjitur me një fotografi të zëvendës-presidentit amerikan, Mike Pence, që kohë më parë kishte vizituar shtetin malazez.

### Ky është reagimi i plotë i Malit të Zi:

Qeveria e Malit të Zi, vlerëson interesimin e një numri të mediave vendase dhe të huaja për t'u përcaktuar në lidhje me deklaratën e Presidentit nga SHBA-ja, Donald Trump dhënë në një intervistë me Fox. Mali i Zi thotë se është krenar për historinë dhe traditën e saj dhe politikën e paqes që ka çuar në pozitën e shtetit më të fuqishëm në rajon dhe në të vetmin shtet në të cilin nuk ka parë rënien e ish-Jugosllavisë. Një vend që mori dhe mbrojti 120.000 njerëz. Shteti që ishte i pari në Evropë ku ofroi rezistencë ndaj fashizmit dhe sot si një anëtar i ri i NATO-s dhe një kandidat për Bashkimin Euro-



Presidenti amerikan, Donald Trump

pian kontribuon në paqen dhe stabilitetin, jo vetëm në kontinentin evropian, por tashmë në mbarë botën, së bashku me ushtarët amerikanë në Afganistan. Ne ndërtojmë miqësi dhe nuk kemi humbur asnjë prej tyre, të aftë për të mbrojtur me guxim dhe me vendosmëri dhe për të mbrojtur interesat tona kombëtare. Në botën e sotme të mbushur me sfida, nuk ka rëndësi se sa të mëdhenj apo të vegjël jeni, por në çfarë mase vlerësoni lirinë, solidaritetin dhe demokracinë. Për shkak të gjithë kësaj miqësie mes Aleancës së Malit të Zi dhe të Shteteve të Bashkuara, është e fortë dhe e përhershme.

Nërkohë që një ditë më parë, presidenti i SHBA-së, Donald Trump, në një interv-

istë për Fox News, jo vetëm aleatët, që ia kanë lënë Shteteve të Bashkuara gjithë barrën e shpenzimeve për mbrojtjen, por edhe traktatet që i konsideron të padrejta. Ajo që u vu re ishte mënyra se si Trump foli për popullin malazez duke thënë se janë gjaknxehtë dhe mund të nisnin luftën e tretë botërore.

**Gazetari:** Të qenit pjesë e NATO-s detyron të gjithë anëtarët të mbrojnë çdo pjesëtar tjetër nga sulmet. Për shembull, nëse sulmohet Mali i Zi, që u anëtarësua vitin e kaluar, pse im bir duhet të shkojë në mbrojtje të këtij vendi?

**Trump:** Po thoni atë që thashë unë, Mali i Zi është një vend i vogël me njerëz shumë të fortë.

**Gazetari:** Nuk jam kundër Malit të Zi, apo Shqipërisë.

**Trump:** Gjithsesi... janë shumë të fortë, agresivë. Mund të nxehen dhe urime, jemi në Luftën e Tretë Botërore. E kuptoj, por kështu janë gjërat. Mos harroni se unë kam vetëm 1 vit e gjysmë këtu, rrimora këtë bisedë pak ditë më parë kur ju thashë: Ju duhet të paguani. Ju duhet të paguani.

Sipas Trump vendet evropiane tregohen të padrejta me Shtetet e Bashkuara, pasi kur vjen fjala për shpenzimet, Uashingtonin mban barrën më të rëndë. Por nuk u vjen mirë kur Shtetet e Bashkuara heqin dorë nga marrëveshja për tregtimin e lirë, të cilën ai e konsideron të disfavorshme për Uashingtonin.

### REAGIMI I QEVERISË MALAZEZE:

Qeveria e Malit të Zi, vlerëson interesimin e një numri të mediave vendase dhe të huaja për t'u përcaktuar në lidhje me deklaratën e Presidentit nga SHBA-ja, Donald Trump, dhënë në një intervistë me Fox. Mali i Zi thotë se është krenar për historinë dhe traditën e tij dhe politikën e paqes që ka çuar në pozitën e shtetit më të fuqishëm në rajon dhe në të vetmin shtet në të cilin nuk ka parë rënien e ish-Jugosllavisë, një vend që mori dhe mbrojti 120.000 njerëz. Shteti që ishte i pari në Evropë ku ofroi rezistencë ndaj fashizmit dhe sot si një anëtar i ri i NATO-s dhe një kandidat për Bashkimin Evropian kontribuon në paqen dhe stabilitetin, jo vetëm në kontinentin evropian por tashmë në mbarë botën, së bashku me ushtarët amerikanë në Afganistan. Ne ndërtojmë miqësi dhe nuk kemi humbur asnjë prej tyre, të aftë për të mbrojtur me guxim dhe me vendosmëri dhe për të mbrojtur interesat tona kombëtare.

### SHKURT

#### Armatoset Bullgaria, pas 15 avionëve miratohet blerja e 2 luftanijeve

Parlamenti i Bullgarisë ka aprovuar blerjen e dy luftanijeve për nevojat e marinës së këtij vendi. Në vendimin e aprovuar të parlamentit bullgar thuhet se luftanijet doemos duhet të jenë shumëdimensionale dhe adekuate për operacione të NATO-s dhe Bashkimit Evropian. Parlamenti aprovoi edhe atë se për këtë blerje nga buxheti ndahen 984 milionë leva bullgare (505 milionë euro). Plani është që luftanija e parë të dorëzohet pesë vite më vonë dhe dy luftanijtë të tjerë të dorëzohen në afatet e mëvonshme. Luftanijet e reja duhet të zëvendësojnë tre anijet e vjetra të prodhimit rus në inventarin e marinës bullgare. Parlamenti më 8 qershor aprovoi blerjen e 15 avionëve luftarakë dhe 154 autobusëve për nevojat e forcave të armatosura të vendit.

#### Nëna rreh 2-vjeçarin për vdekje, ja çjustifikim nxjerr në gjykatë

Një nënë nga Dakota e Jugut, e cila rrahu djalin e saj për vdekje pasi ai lagu shtratin është dënuar me 40 vjet burg. Katrina Shangreux pranoi se kishte rrahur djalin e saj Kylene, vetëm dy vjeç, me një rrip. Ajo e kishte përplasur në tokë duke e goditur në stomak kur u kthye në shtëpi më 28 korrik 2016 dhe pa që djali kishte lagur shtratin. Ajo tha për gjykatën se kishte pirë shumë dhe se ishte nën efektin e medikamenteve. Pas vdekjes së foshnjës, Shangreux dhe nëna e saj, Sonya Dubray, pastruan gjakun dhe u përpoqën të zhduknin çdo shenjë. Më pas ata telefonuan policinë duke thënë se djali kishte vdekur duke pirë lëng molle. 30-vjeçarja u deklarua fajtores për vrasje të shkallës së dytë dhe u dënua me 40 vite burg.

#### Izraeli, 'shtet kombëtar hebre'

Parlamenti i Izraelit ka miratuar një ligj, i cili e përcakton vendin si ekskluzivisht hebre. Ligji "shteti kombëtar hebre" do të statusin e arabishtes si gjuhë zyrtare dhe thotë se gjuhë hebraike është prioritet kombëtar. Ai, gjithashtu, thotë se Jerusalemi "i tërë dhe i bashkuar" është kryeqyteti i Izraelit. Deputetët arabë izraelitë dënuan legjislacionin, por kryeministri Benjamin Netanyahu e vlerësoi atë si një "moment përcaktues". Ajo u miratua pas një seance me debate në Kneset që zgjati më shumë se tetë orë. 62 deputetë votuan për projektligjin, me 55 kundër.

### 'Kapen' nga telekamerat, burimi: Të dyshuarit janë rusë

#### At e bijë helmohen me agent nervor, identifikohen në Britani autorët e dyshuar

Policia britanike ka identifikuar autorët e dyshuar të sulmit kundër ish-spiunit, rus Sergei Skripal dhe vajzës së tij Yulia, që ka ndodhur në Salisbury, në mars të këtij viti. Një burim anonim pranë hetimit ka thënë që autorët e dyshuar janë identifikuar nëpërmjet pamjeve të telekamerave të instaluar nëpër rrugët e qytetit. Në tentativën e helmimit me agjentin nervor Novichok duket se janë përfshirë shumë rusë. "Investiguesit besojnë që kanë identifikuar fajtorët e dyshuar në sulmin me Novichok nëpërmjet telekamerave të sigurisë dhe kanë bërë një kontroll të personave që kanë hyrë

dhe dalë nga vendi në këtë periudhë. Hetuesit janë të sigurt që të dyshuarit janë rusë", ka thënë burimi. Policia mendon që rusët të ndryshëm janë përfshirë në tentativën e vrasjes së ish-agjentit rus dhe vajzës së tij dhe po kërkohet më shumë se një të dyshuar, thotë agjencia Association Press. Rasti i helmimit të ish-spiunit rus Sergei Skripal dhe vajzës së tij mund të kishte përfunduar me vdekjen e tyre. Këtë e kanë pranuar doktorët të cilët u kujdesën për kurimin e familjes që ra për e një sulmi me agjent nervor në 4 mars, në Angli. Doktorët, gjithashtu, deklar-




Ish-spiuni rus, Sergei Skripal dhe vajza e tij, Yulia

luan se nuk është ende i qartë ndikimi që do të ketë helmimi për shëndetin e Skripalëve në afatgjatë. Doktorët përgjegjës për kurimin e familjes Skripal deklaruan se ata nuk prisnin që viktimat e sulmit me agjent nervor të mbijetonin. Në një intervistë për rrjetin britanik

BBC, stafi i spitalit Salisbury pranoi se rasti i helmimit të Sergei dhe Yulia Skripal ishte aq i rëndë, sa që pati dyshime nëse atë e bijë do të mund t'i rezistonin ekspozimit ndaj helmit Novichok. Sipas stafit mjekësor, nuk është e sigurt çfarë ndikimi mund të ketë episodi i helm-

imit në shëndetin e Skripalëve në afatgjatë. Doktorët, gjithashtu, deklaruan se dyshimet fillestare ishin se atë e bijë kishin kaluar në mbidozë opioide, përpara se diagnoza të ndryshonte dhe kimikati helmues të identifikohet si agjenti i fuqishëm nervor Novichok. Kujtojmë se Sergei Skripal, një ish-kolonel i inteligjencës ushtarake ruse dhe vajza e tij Yulia, u gjetën pa ndjenja në një stol publik në qytetin jugor anglez të Salisbury-t në 4 mars. Britania fajësoi Rusinë si përgjegjëse për helmimin e Skripalëve dhe qeveritë perëndimore, përfshi edhe Shtetet e Bashkuara, përjashtuan më se 120 diplomatë rusë. Por Kremlini zyrtar mohoi të jetë përfshirë në incident dhe u kundërpërgjigj në të njëjtën mënyrë.

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

2. Gjëja e latinëve.
5. Ai i Kuq u hap për hebrejtë.
9. Eshhtë fjala e për e foshnjës.
11. Ministri Ekonomisë e Pune
13. Marubi i fotografisë.
14. Bel i Mapupassant.
15. Bëhet duke tregtuar objekte të shenja.
18. Derek aktore.
19. Gjysmë totale.
20. Eshhtë art i të folurit
22. Një patriark biblik.
24. Mund të jenë zemërkau të tilla.
26. Janë dëshmorë të kishës.
28. Eshhtë lloj papagalli.
29. Eshhtë lloj papagalli.
30. Qerre pa qe.
32. Ekstremit në numërim.
33. Eshhtë bodrumi.

34. Steiger aktor.
35. Inicialet e Delon.
37. Eshhtë edhe ai Me Gropa.
38. Një mund të jetë autonom.
40. Në krye yë evidencës.
42. Edgar Allan Poe.
44. Ekstremit në iitar.
46. Giorgio i modës.
50. Janë malet me Akonkagua.
52. Janë ujërat e bregdetit tonë.

**VERTIKAL**

1. Novarro që qe aktor.
3. Kusturica regjisor.
4. Eshhtë e jashtëzakonshme.
6. Inicialet e Kazan.
7. Ishte qyteti i 100 portave.
8. Pinci i Dy herë mat.
9. Janë të mirat që prodhohen.
10. Eshhtë ai që gënjën për t'u bërë i njohur.
11. Një markë celulari.
12. Ushtrrohej nga filibusterët.
16. Një përsiatje.
17. Agjenci Informativ Tiranë.
21. Një brejtës pylli.
23. Një Gjon që qe aktor i yni.
25. Titulli i Byron.
27. Në radhë të parë.
31. Emri i Amundsen.
36. Moore aktore.
39. Pishtarë pa pishë.
41. Gjysmë vatani.
43. Rruga e Molnar.
45. Një fazë gjumi.
47. Inicialet e Redford.
48. Në krye të notarëve.
49. Inicialet e Reitman.
51. Unë dhe ti.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Nuk kalohet nga mbetësi.
5. U printe gladiatorëve
12. Bëhet duke shkuar lart e më lart
14. Tatum që qe pianist.
15. Një që lufton për para
16. Mund të bëhet me safari
17. Breshkat luftarake të kartonave
19. Ngjitet kur nuk nget
20. Në mes të rrugës
21. Sporti me rikisha
25. U shkrua nga Hesiodi
26. Një sferë për model
27. Mbyllin një sirtar
28. Makina Tipò
30. Inicialet e Bean, aktor
31. Nino, kompozitor i famshëm italian
33. Ramiro pa zë.
34. Neill i Jurassic park.

**VERTIKAL**


35. E bukura e belle epoques.
37. Qe mbreti i elfëve
39. Farrow, aktore
40. Hagen rockstar
41. Walter i Kush do ta vrasë Charley Verrik
45. Në fund majtas
46. Mund të preken nga autobus i Basedow
47. Ad... për të ngarkuarin me punë
48. Loach regjisor
9. Qytet zviceran
10. Në krye të kryesisë
11. Ughi violinist
13. Carlos që qe pilot i Formula 1
15. Ekstremit në muzg
18. Inicialet e Steinbeck
22. Gruda, "Njeriu me top"
23. Eshhtë X ajo e sulmit
24. Paradhoma e parajasës
28. Eshhtë edhe ai i luftës
29. Janë edhe ato të cirkut
31. Mbarojnë fare
32. Inicialet e Reed, aktor
34. Të parët në sondazh
36. Eshhtë taksa
38. Një mund të jetë emërora
39. Një pjesë e marrëzisë
41. Gjysmë mimoze
42. Hundë kur s'jam unë
43. Skuadër greke
44. Lemper, këngëtare gjermane
46. Fundi i një akti




**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



FJALËKRYQI (1)



- Kur qeveria çon një popull në shtatërrim nga të gjitha rrugët, revolucioni nuk është më një e drejtë e qytetarëve, por një detyrë.
- "Fal"... sepse një ditë ju do të keni nevojë për një falje !!!
- Mos trokit në derën e dikujt që e hap atë për të gjithë ... sepse miku i të gjithëve nuk është miku i askujt !!!
- Ai që tradhton besimin tim, nuk vlen as respektin tim !!!
- Thonë se të gjithë njerëzit janë si hëna, kanë një anë të cilën kurrë nuk ia tregojnë askujt !!!

**SUDOK**

		6		7		
1						
	8	9		1	5	
6		3	7	8		
				3		9
		7	4	9	1	
7		4	9		6	3
8		5				4
9			3			



Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

5	8	3	7	9	2	6	1	4
1	6	4	8	3	5	9	2	7
2	7	9	4	1	6	8	3	5
6	9	8	1	4	3	5	7	2
7	3	2	6	5	8	1	4	9
4	1	5	9	2	7	3	6	8
8	4	7	5	6	1	2	9	3
9	2	6	3	8	4	7	5	1
3	5	1	2	7	9	4	8	6

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm



- Gabimi më i madh në jetë është të lejosh disa njerëz të qëndrojnë në jetën tuaj më shumë se sa e meritojnë!!!
- Të dashurosh dikë që nuk të do, është sikur të presësh një anije në aeroport.
- "Djemtë mendojnë se vajzat janë si libra. Nëse kopertina nuk tërheq vëmendjen e tyre, ata nuk shqetësohen për të lexuar
- atë që ekziston brenda". -Marylin Monroe
- E kaluara është mësuesi i së tashmes dhe udhëzuesi i së ardhmes.
- Kuptimi i vërtetë i jetës është të mbjellësh një pemë, nën hijen e së cilës nuk prisni për t'u ulur.

**Thënie të mençura**

